

Kumbona e së Diellës



KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

Nr.3/4, Mars - Prill 2019

NGJARJET NË DITËT E MËDHA TË PASHKËS TË ZHVILLUARA NË KATEDRALËN E SHKODRËS



*E Enjta e Madhe:
Bekimi i Vajrave te Shenjte.*

*E Premtja e Madhe:
Përkujtimi i Mundimeve
të Jezu Krishtit.*



*E shtuna:
Dita e heshtjes
dhe ngadhënjimi i Kryqit - Ngjallja*



*E diela:
Ditë gëzimi dhe shprese*





Mons. Angelo Massafra
MESAZH PËR PASHKËN 2019 4

Redaksia
PASHKA - ORIGJINA 6

Redaksia
E SHTUNA E MADHE, DITA E HESHTJES 9

Don Lush Gjergji
JEZUSI ËSHTË I GJALLË EDHE SOT 11

Giandomenico Mucci
NËSE BESIMI ËSHTË I DOBËT 14

Don Nosh Gjollaj
KRIZA E IDENTITETIT
SI MASHKULL DHE SI BABË 15

Xhonti Bardhi
BOTËKUPTIMI MBI NJERIUN
NË MENDIMIN E EDMUND HUSSERL-IT 19

Mërgim Korça
HISTORIA DHE
MUSTAFA MERLIKA KRUJA 21

Leonora Laçi
IMZOT FRANO GJINI 23

Dr. Tonin Çobani
TRE TREGIME NGA JETA E NËNË TEREZËS 25

Redaksia
120 VITE SHOQËRIA "BASHKIMI" 27

VITRINA E LIBRIT 28

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXII, nr. 3/4 (517-518) Mars - Prill 2019

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Dom Vlash Palaj
Dom Gjovalin Simoni

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon NIKA

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

MESAZH PËR PASHKËN 2019

*Shko te vëllezërit e mi e thuaju:
Po ngjitem tek Ati im e Ati juaj, tek Hyji im e Hyji juaj”
(Gjn 20, 17).*

Për urimet e mia për Pashkën 2019 këtë vit kam zgjedhur rreshtin e Ungjillit të Gjonit ku përshkruhet përvoja e të Ngjallurit, që bën Maria Magdalenë, figura e Kishës që është në kërkim të Zotit të vet. Edhe pse Krishti është ngjallur (ngjarje e gëzueshme dhe e aftë që ta shndërrojë ekzistencën tonë) gëzimi ynë nuk është i përsosur dhe i plotë deri kur, ashtu si për Marinë Magdalenë, edhe për ne nuk do të realizohet takimi me të Gjallin (shih Zb 1, 18).

Për fenë tonë mjaftojnë shenjat e Ngjalljes: ashtu si Gjoni apostull, edhe ne, që në ditët e Mundimeve e kemi ndjekur Jezusin, i kemi rijetuar ngjarjet e Kryqëzimit dhe të Vdekjes së tij, të drejtuar prej dashurisë, na mjafton të dimë se varri ku e kishin vënë tani është bosh.

Por kjo nuk mjafton, që fesë sonë t'i bashkohet edhe përmasa e gëzimit të brendshëm dhe të jashtëm. Nevojitet një “më shumë”, që është takimi dhe përqafimi me Zotin e kryqëzuar dhe të ngjallur, sepse i dashuri, për t'u gëzuar plotësisht, nuk kënaqet me shenjat e të dashurit të vet, por dëshiron

ta takojë atë, t'i qëndrojë afër, ta shtrëngojë fort pas vetes.

Edhe ne, Kisha në Shkodër-Pult, jemi duke kërkuar të Dashurin, duke bërë atë rrugëtim që bën edhe nusja e Këngës së Këngëve (krh. Kk 3, 2), duke kapërcyer rrugë e sheshe, veç që të arrijë në agim për ta takuar, për ta përqaftuar dhe për të mos e lënë kurrë më atë. Shkojmë duke përsëritur emrin e tij, duke ua thënë edhe të tjerëve, që ta kërkojnë së bashku me ne dhe, pasi ta gjejnë, të gëzojnë edhe ata.

Por këtë takim ne e bëjmë çdo ditë: ashtu si Marisë, edhe neve i Ngjalluri na e drejton Fjalën e Vet; madje na thërret në emër, duke na zbuluar në këtë mënyrë se sa shumë ai na njeh dhe na do, sepse njohja dhe dashuria shkojnë së bashku; edhe ne e thërrasim në emër, duke bërë që ky emër të tingëllojë në asamblëtë tona, sepse emrin i tij është “emri që është mbi çdo emër” (Fil 2, 9). Dhe çdo ditë ai, i Ngjalluri, na jepet neve në formën e bukës dhe të verës eukaristike, sepse dashuria e tij për ne nuk është vetëm “me fjalë”, por konkrete: nuk



mjaftohet që të na bëjë “ta ndiejmë” Fjalën e Tij, por dëshiron edhe që të jetojë me ne një bashkim të thellë, që ne e quajmë “bashkësi”. Dhe, si të mos mjaftonte, na mbush me Shpirtin e Vet që gjallëron të gjitha veprimet tona.

Këtë gjë bëjmë ne si Kishë çdo ditë!

Ka vetëm një problem: sa kjo e vepruar kishtare është edhe e vepruar e çdo besimtari? Duhet ta bëjmë këtë pyetje, të dashur vëllezër e motra! Kjo pyetje është thelbësore për jetën tonë të fesë. Pasi, nëse nuk është kështu, përvoja jonë e të Ngjallurit nuk do të ishte e plotë.

Në fakt, Marisë Magdalenë i jepet edhe një detyrë e rëndësishme: t’ua kumtojë të Ngjallurin vëllezërve të vet dhe motrave të veta. Përmbajtja e këtij kumtimi është po aq e rëndësishme: “po ngjitem tek Ati im e Ati juaj, tek Hyji im e Hyji juaj” (Gjn 20,17), që tregon hyjninë reale të Jezusit.

Në një kontekst si ky i yni, fortësisht të prekur prej relativizmit, rrezikojmë që ta ulim angazhimin tonë misionar, duke lënë që vëllezërit e motrat tona të jetojnë larg Krishtit: nuk e kumtojmë më, nuk ia tregojmë të tjerëve fuqinë e emrit të tij që shëron, fal e shpëton. Ashtu si Pjetri e Gjoni që ngjiteshin në tempull për t’u lutur, edhe ne i takojmë ata që kanë nevojë për t’u shëruar prej paralizës së vet; edhe ne mund t’i kumtojmë këto fjalë të fesë: “Unë nuk kam as argjend, as ar, por po të jap çka kam: në emër të Jezu Krishtit Nazarenas, ec!” (Vap 3, 6).

Kisha jeton një moment të vështirë, Shtetet


jetojnë një moment të vështirë, por edhe individët e ndiejnë vështirësinë për të jetuar që, ndonjëherë, i ngjan një lufte për mbijetesë. Duke pasur parasysh faktin se e kemi përjetuar brishtësinë e përpjekjeve tona vetëm njerëzore për t’i zgjidhur këto çështje, për t’u ngjallur edhe ne, çfarë presim për t’iu besuar fuqisë së këtij Emri? Sepse “nëpër Të fitohet shëlbimi; sepse, për të vërtetë, s’ka asnjë person tjetër nën këtë kupë qielli që Hyji ua dha njerëzve me anën e të cilit do të mund të shëlbohemi» (Vap 4, 12).

Për këtë arsye, ju uroj të gjithëve ju që të dini ta mikpritni kumtimin e Emrit të Jezusit të Ngjallur: Ai na shpëtoftë dhe e liroftë Shqipërinë tonë prej padrejtësive, prej mendjemadhësisë, prej etjes për pushtet dhe zotërim, pasi këto gjëra shkaktojnë urrejtje, hakmarrje dhe vrasje. Ai na dhaftë guximin e nevojshëm për të fituar mbi çdo formë egoizmi, forcën për t’u angazhuar për të mirën e përbashkët në krijimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të vëmendshme ndaj nevojave të më nevojtarëve dhe gëzimin e brendshëm e të thellë të atij që, meqë ka takuar dhe përqaftuar Atë, është i gatshëm ta jetojë urdhërimin e dashurisë (krh. Gjn 15, 10-11).

Në emër të Jezu Krishtit, të kryqëzuar dhe të ngjallur, përshumëvjet Pashkën 2019.

† Angelo Massafra O.F.M.

Arqipeshkëv Metropolit Shkodër-Pult



PASHKA, NGA ORIGJINA DERI TE DATA E LËVIZSHME : GJËRAT QË DUHEN DITUR

Është festa më e rëndësishme për ne të krishterët dhe etimologjikisht nënkupton « kalimin ». Data lëviz pasi varet nga hëna e plotë e pranverës, ndërkohë që origjina e festës lidhet me botën hebraike, veçanërisht me festën Pessach, në të cilën festohej kalimi i Izraelit, përmes Detit të Kuq, nga skllavëria e Egjiptit në liri.

Pashka është dita ku vërehet më saktë përkushtimi që ne bëjmë për tre ditë, është qendra dhe zemra e të gjithë vitit liturgjik. Është festa më solemne që vazhdon me tetë ditshin e Pashkës me kohën liturgjike të Pashkëve, e cila zgjat 50 ditë, inkorporuar festimit të ringjalljes, deri në solemnitetin e Rrëshajëve.

Cili është kuptimi i fjalës “Pashkë”?

Rrjedh nga greqishtja “pascha », nga ana tjetër vjen nga aramaishtja « pasah », e cila nënkupton « të kalosh përtej », pra kalimin. Hebrenjtë e rikujtonin kalimin mes Detit të Kuq, nga skllavëria e Egjiptit në liri. Për të krishterët është festa e kalimit nga vdekja te jeta e Jezu Krishtit.

Cilat janë origjinat e kësaj feste ?

Duke u nisur nga hebrenjtë Pashka (Pessach) e kishte origjinën e lidhur me aktivitetet bujqësore dhe ishte festa e mbledhjes së frutave të para të fshatit, duke filluar me grurin. Të tjera festa, sa për t'u kujtuar ishin: festa e “Javëve”, e cila festonte mbledhjen e grurit në ditët e para të qershorit, dhe festa e “Çadrave”, pra e korreve, e cila festohej në shtator. Në vazhdim, Pashka bëhet celebrimi vjetor, i lirimit të hebrenjve nga skllavëria, si largim i

Egjiptit dhe lidhet me faktin që me gjakun e qengjave, janë lyer dyert e portave, deri kur “qengji shfarosës”, siç thuhet në bibël, duke kaluar nga ato dyer, ruan të Paralindurin.

Edhe sot, dreka e Pashkës, zhvillohet sipas një urdhri preciz të quajtur Seder. Ushqehemi me ushqime të kripura, që të kujtojmë të hidhurën e skllavërisë egjiptiane dhe habinë e lirisë së rigjetur. Për të festuar Pashkën, izraelitët në kohën e Jezusit, çdo vit shkonin në Jerusalemin. Jezusi është qengji i Pashkës, buka e re, që të bën të ri.

Përse ushqehemi me qengj?

Tradita e të ushqyerit të qengjit për Pashkë, rrjedh nga Pessach, Pashka hebraike. Qengji bën pjesë në origjinën e këtij festimi. Veçanërisht lidhet me momentin kur Zoti i drejtohet popullit duke i thënë se Ai do t'i liron: “Në këtë natë unë do të kaloj përmes Egjiptit e do të vras të gjithë të paralindurit egjiptian, si nga njerëzit ashtu edhe nga bagëtisë”. Duke urdhëruar kështu popullin izraelit të shënjojnë portat e shtëpive me gjakun e marrë nga qengjat, në mënyrë që Ai të dinte se kë të gjuante e kë jo. Ndërkohë që në të kaluarën ekzistonte një urdhër, që lidhet me Pashkët hebraike, ku thuhej që të sakrifikohej qengji, në ditën e 14, të muajit hebraik, Nisanit, dhe të konsumohej po në të njëjtën natë sakrifica e Pesachit.

Me krishterimin, simboli i qengjit të therur për të mirën e të gjithëve, bëhet vetë Krishti dhe sakrifikimi i tij ka një vlerë të qenësishme.

Përse ndryshon data e Pashkës?

Pasi lidhet me hënën e plotë të pranverës. Data e Pashkës, në botën e krishterë që një shtysë e një sërë kontradiktave mes Kishave lindore me atyre perëndimore, e para ishte formuar nga hebrenjtë të konvertuar dhe festonin fill pas Pashkës hebraike, pra në ditën e Hënës së plotë, më 14 Nisan, muaji i parë i vitit hebraik; pra gjithnjë në ditë të ndryshme të javës. Vetëm me Këshillin e Niceas, në 325, vendoset që duhet të festohet në të njëjtën ditë për të gjithë të krishterët,



duke e fiksuar në ditën e diele, e cila pasonte hënën e plotë të pranverës. Tani Pashkët takojnë nga data 22 mars deri në 25 prill, duke e quajtur atë Pashkë të lartë apo ë ulët, në varësi të periudhës kur bie.

Si zhvillohet simbolika e mbrojtjes së Pashkëve?

Ajo është një celebrim kompleks dhe unitar, e cila zhvillohet në këto katër hapa:

Liturgjia e dritës – e cila nis me bekimin e zjarrit, procesioni është i përfshirë në kishën e errët, pra zjarri ndriçon kishën.

Liturgjia e fjalës – me 9 lexime, 7 të trajtuara te Testamenti Antik dhe 2 te i Riu.

Liturgjia e Pagëzimit

Liturgjia Eukaristike - riti zhvillohet natën, si simbolikë e njerëzimit, që pa Krishtin, është i përfshirë në errësirën e mëkatit, në gabime dhe në vdekje.

Përse përdoren vezët?

Tradita e ngjyrosjes së vezëve e ka pikënisjen që me piktorët, të cilët pikturonin vezët e tyre me të kuqe, për të kujtuar gjakun e Krishtit dhe e dekoronin me kryqe e simbole të tjera, një traditë e cila vazhdon ende sot, nga të gjithë besimtarët tashmë. Simbolika e vezëve është e dukshme: nga veza lind jeta, që lidhet me rilindjen e Krishtit, pra me Pashkën. Në fakt, vezët e ngjyera do të kishin kuptim edhe për Krishtlindje, si kujtim i lindjes së Krishtit, por sipas disa studimeve, tradita e vezëve të Pashkës, forcohet nga Kreshmët e mëdha, periudha e 40 ditëve përpara Pashkëve, në të cilën besimtarët agjërojnë. Gjatë kësaj kohe është e ndaluar që të hahet mishi.

Në të kaluarën dhe tani në kishat lindore ishte e ndaluar që të haheshin edhe vezët. Por, ishte e pamundur që të ndalohej prodhimi i vezëve, andaj u gjendej përballë shumë vezëve që nuk mund të haheshin.

Nga nevoja për të bërë diçka, lindi traditë e zierjes së vezëve, derisa të bëheshin të forta si guri, pastaj u pikturonin me ngjyra të shenjta e simbolike.

Buka

Buka është produkt kryesor ushqimor i njeriut dhe për këtë edhe në kult ka një domethënie të madhe. Ashtu si gjaku dhe frymëmarrja edhe buka e përditshme është kusht i pazëvendësueshme për jetën e njeriut. Buka sipas ps 104, 15 është burim force për njeriun. Buka simbolizon jetën, kështu që “kur mungon buka, mungon gjithçka”. Sipas biblës

“ai që vuan e që duket se zoti e braktis, ha bukë 'me lot', me ankth, ose 'me hi' (ps 42, 4; 80, 6; 102, 10; is 30, 20); kush është i gëzuar e ha me gëzim (kish 9, 7). T'ia hash dikujt bukën do të thotë të jesh miku i tij. Tradita jonë shqiptare mëson se kur dikush e ka vra dikën që sapo ka dalë prej shtëpisë së tij, ku ka kërkuar strehim, edhe pse i panjohur deri atëherë, ke ra në gjak me atë familje. Sikur njeriu ashtu edhe buka vjen prej tokës dhe kështu bëhet shprehje e mishërimit të ekzistencës njerëzore. Në këtë kuptim përdoret edhe si dhuratë për fli. Buka është fryt i mundit tonë, shprehje për veprën e duarve tona. Për të vjetrit buka është dhuratë e zotit. Shkrimi shenjt flet shumë mbi bukën. Në bv lexojmë se zoti për 40 vjet e ushqeu popullin me bukën e ardhur nga qielli që e quajtën 'mana' (dal 16, 31). Mrekullia më e madhe e Jezusi është ajo e shumimit të bukëve (lk 9, 10-21). Kështu buka bëhet “dhuratë më e madhe e epokës eskatologjike (is 30, 23), si dhe e gostisë mesianike (jer 31, 12). Ngrënia e Jezusit me të vetët paralajmëron gostinë eskatologjike. Legjislacioni priftëror u jep një rëndësi të madhe bukëve “të kushtimit”, të vëna në tempull mbi një tryezë (1 mbr 7, 48; 2 kron 13, 11; krah. Dal 25, 23-30). Prejardhja e tyre duket e lashtë (1 sal 21, 5). Për Izraelin këto bukë bëhen simbol i bashkimit mes perëndisë dhe besimtarëve... bukët e fryteve të para bënte pjesë në ofertën e sjellë në festën e javëve (lev 23, 17). Që në kodet më të lashta bukët pa tharm shoqërojnë fljimet (dal 23, 18; 34, 25) dhe përbëjnë ushqimin e popullit të izraelit gjatë festës pranverore. Tharmi ishte përjashtuar nga oferta kultuale (lev 2, 11) (shiko: “fjalori i teologjisë biblike” fq. 124-125)’. Bekimi i bukës së pashkëve ka një lidhshmëri me pashkët e para në Egjipt, por edhe me atë që bëri jezusi në darkën e mbarmë, kur e themeloi eukaristinë, në të cilën na epen neve për ushqim. Kështu krishti bëhet buka jonë.

Vera

Gruri, vaji dhe vera në tokën e shenjtë bëjnë pjesë në ushqimin e përditshëm (lp 8, 8; 11, 14) vera në bv tregon gëzimin e jetës e njeriut. Vera e gëzon zemrën e njeriut (ps 104, 15). Kështu vera bëhet element i gostisë mesianike dhe i gostisë eukaristike. Sipas traditës jahvistike noehi e zbuloi hardhinë e parë (zan 9, 20). “duke ardhur nga zoti si të gjitha prodhimet e tokës, vera do të ketë vendin e saj në fljimet. Që në kohët e lashta në shenjtëroren e vjetër të silos silleshin oferta vere... vera bën pjesë edhe në frytet e para që u takojnë priftërinjve (lp 18, 4; nr 18, 12; 2 kron 31, 5). Së fundi ajo do të

zë një vend në sakrificën e besëlidhjes së re që do t'i japë fund këtij rituali” (shiko: “fjalori i teologjisë biblike” f. 1058). Vera do të përdoret në gostinë e fundit, në të cilën hyji do t'i ftojë të gjithë popujt (Is 25, 6). Jezusi është hardhia e vërtetë (15, 1), i cili i realizon premtimet e hyjit.

Kurora

Kurora bën pjesë në një prej simboleve më të vjetra të sundimit. Forma e rrumbullakët e pushtetit tregon në tërësi, përsosmëri dhe pjesëmarrje në qenien hyjnore. Inkronizimi i një mbreti apo perandori është festë e madhe. Sipas traditës biblike njerëzit e inkronizuar janë nën mbrojtjen dhe hirin e zotit (ps 103, 4). Kush i ngelet zotit besnik deri në vdekje, do të kurorëzohet me “kezën e jetës” (zb 2, 10). Kurora me ferra mbi kokën e Jezusit është shenjë poshtërimi dhe talljeje nga ana e hebrenjve dhe njëkohësisht e paraqet Jezusin në vuajtje si mbret të paqes.

Kryqi

Kryqi bën pjesë në një ndër simbolet e vjetra më të përhapura. Me formën e tij të një kuadrati simbolizon katër anët e botës. Në krishterim me kryqëzimin e Krishtit kryqi merr një domethënie të re si simbol i vuajtjeve dhe i ngjalljes së Krishtit dhe kështu bëhet simbol i të gjithë të krishterëve. Kryqi na tregon drejtimet që janë të rëndësishme për udhëtimin tonë: nga lart poshtë apo diagonalja tregon se jemi të lidhur me zotin, ndërsa nga e majta në të djathtë apo horizontalja tregon se jemi të lidhur me njëri-tjetrin.

Qiriu

qiriu i ka rrënjët në traditën pagane dhe në atë judaike. Shërbente si dhuratë flie për zotin dhe si shtyllë zjarri për br. Sikur që dikur izraelitët duke e ndjekur shtyllën e zjarrtë kaluan detin e kuq dhe ecën nëpër shkretëtirë, ashtu sot kalojnë të krishterët natën e pashkëve në kishë, duke ndjekur flakën e ndezur të qiriut, shenjë të ngadhënjimit nga skllavëria e mëkatit në jetën e hirit, nga vdekja në jetë. Dëshminë më të vjetër që flet për përdorimin e qiriut të pashkëve e gjejmë në letrën e Shën Jeronimit drejtuar xhakonit presidie nga piacenza në vitin 384.

Qiriu i pashkëve prodhohet nga dylli i bletëve. Bleta është insekti më i bekuar, prej të cilit rrjedh mjalti, që e mbledh me shumë duresë, kujdes dhe dashuri. Bleta është e njohur për një rregull të jashtëzakonshëm brenda familjes, që ua tejkalon të gjitha familjeve njerëzore; për precizitet, që ua kalon të gjithë matematikanëve; për prodhim të shijshëm dhe të ëmbël, që ia kalon çdo prodhimi njerëzor; për qëndrueshmëri dhe paprishmëri pa afat skadence dhe për efekt shëndetësor marramendës. Ekspozimi i qiriut të pashkëve, i prodhuar me material blete na fton të mendojmë për efektet shumë më të vlefshme, të cilat i ka në vete ky simbol që dhuron dritë. Sikurse pa dritë nuk ka jetë, ashtu edhe pa Krishtin nuk mund ta gëzojmë jetën në vetvete, në familje dhe në shoqëri. Për këtë arsye, ndezja e qiriut nga zjarri i pashkëve, hyrja me të nëpër kishën e errët dhe klithja e trefishtë „ja drita e Krishtit!“, tregon se Krishti është triumfues mbi errësirën e kësaj bote. Kënde, kënga exultet e qiriut të pashkëve është kënga më e bukura dhe më e para



E SHTUNA E MADHE, DITA E HESHTJES

E Shtuna e Madhe është dita e “ndërmjetme”: ndërmjet dhimbjes së thellë për vdekjen e Jezusit - e gëzimit për Ngjalljen. Nuk kremtohen liturgji. Njeriu hesht! Hesht edhe bashkësia. Mbi gjithësinë ndehet heshtja e thellë, që të kujton përhumbjen e apostujve pas vdekjes së Krishtit. Protagonistë të kësaj dite, ndërmjet trishtimit - e gëzimit, janë gjunjëzimi me lot në sy para Kryqit, në meditim e në pritje...

R. SH. - Vatikan

Të Shtunën e Shenjtë, apo të Madhe, dikush e ka quajtur, me të drejtë “dita më e gjatë”, kohë reflektimi, që lind ndër të gjitha zemrat besimtare. Ditë pa kremtime. Ditë “aliturgjike”, kur mungon ngushëllimi i Eukaristisë e i krishteri jeton tronditjen e Apostujve pas vdekjes së Krishtit. Jeton hutimin e pret rizgjimin. Nësa afrohet muzgu i rilindjes së shpresave, që deri në këto çaste dukeshin të humbura... E Shtuna e Madhe është dita e “krizës” së Fjalës: vetë Ungjijtë mbeten pa zë. Mundemi vetëm ta përfytyrojmë Korpën e Krishtit në varr, e apostujt, duke qenë ajo ditë pushimi për hebrejtë, plotësisht të hutuar, ngaqë nuk e dinë ç'ka ngjarë pas zbritjes së Zotit nga kryqi - në honin e vdekjes.

Heshtja e së Shtunës së Madhe nis vonë

Nis vonë, heshtja e thellë liturgjike e së Shtunës së Madhe: me reformën liturgjike të Paut XII. Nis, për të rikujtuar heshtjen e hidhur të ndjekësve të Krishtit, atë të shtunë, kur Zoti që mbyllur në varr, si të ishte vetëm njeri. Rinis heshtja, që të krishterët të mund të meditojnë në këtë ditë vdekjen e Krishtit e edhe vdekjen e vet, duke u ushtruar, kështu, për ta pritur orën e fundit të jetës së tyre tokësore. Në këtë ditë edhe feja ndjehet ligsh, sepse Mesia vdiq e njeriu nuk e ka të lehtë ta kuptojë ç'do të ndodhë më pas. Mundet vetëm të rrojë në pritje. Njeriu pret në këtë ditë heshtjeje orën kur zbrazësia të rimbushet e heshtja e vdekjes të kthehet në himn për jetën!

Dita e zbritjes në mbretërinë e të vdekurve

Gjithçka hesht, por jo Krishti. Krishti vepron. Sipas traditës së lashtë, në këtë ditë Jezusi zbret në mbretërinë e të vdekurve, në thellësi të saj, për ta shpëtuar njeriun e për ta marrë me vete në qiell, ku na paraprin e na pret me krahë hapur! Atje ku zbret, Zoti takohet me Adamin, njeriun e parë, simbol i mbarënjëzimit. E shkund, e zgjon nga gjumi dhe i jep lajmin e shëlbimit, nga i cili nuk përjashtohet askush, duke hedhur, kështu, një urë ndërmjet varrit e mbretërisë së Zotit. Jezusi ngjesh armën e pagabueshme të kryqit: “e mund vdekjen- me vdekje!”.

Ora e Nënës

Prej tridhjetë vjetësh e Shtuna e Madhe është edhe dita në të cilën, sipas traditës bizantine, kremtohet “Ora e Nënës”. Gjithë vëmendja përqendrohet mbi Marinë, zemra e së cilës rreh me trishtim e gëzim njëherësh. Trishtim për vdekjen e Birit, gëzim, me parandjenjen e pagabueshme të Nënës, për ringjalljen. Maria sonte është “Zoja e Dhimbshme”, për traditën shqiptare, “Zoja me shtatë hanxharë”, që ia shporojnë zemrën, si heshta e centurionit të Birit. E lamë te këmbët e kryqit, pranë të Jezusit, që vdiq duke ia besuar Gjonit, ngaqë e dinte se është e thirrur për Misionin e Nënës, e nuk mund të mbetej pa fëmijë. Prandaj, pas Gjonit, do të ketë miliona bij e bija, sa të rrojë gjithësinë. Po sonte është Nëna e dhimbjeve dhe e fesë. E pikërisht nga dhimbja e feja e saj lind Kisha mbarë, që është aty, me Të, te këmbët e Kryqit, ku nis të rrezatojë shpresa. Nga Viti marian i 1987-të, ky kremtim në Romë zhvillohet në Bazilikën e Shën Marisë së Madhe.

Mesazhi i Patriarkëve dhe i krerëve të Kishave të Jeruzalemit për Pashkë

Mesazhi i Pashkëve, që Patriarkët dhe krerët e Kishave të Jeruzalemit u drejtojnë besimtarëve këtë vit, është ftesë për lutje që të ruhet “statusi shumëfetar e shumëkulturore i Jeruzalemit e të gjitha fetë abramitike të shohin në të vetëm qytetin e paqes e të qetësisë”.

-R. Sh. Vatikan

“Jeruzalemi, qyteti i ringjalljes, është fener shprese dhe jete. Qyteti i jetës është edhe qyteti i paqes e i pajtimit. Prandaj, statusi shumëfetar e shumëkulturore i Jeruzalemit duhet ruajtur, që të gjitha fetë abramitike të shohin në të vetëm qytetin e paqes e të qetësisë. Të vijojmë të lutemi për një paqe të drejtë dhe afatgjatë në Jeruzalem e në gjithë botën”. Ky është thelbi i Mesazhit të Pashkëve, që Patriarkët dhe krerët e Kishave të Jeruzalemit u drejtojnë besimtarëve këtë vit, duke i ftuar të luten “me vendosmëri për të gjitha rajonet ku mbretëron dhuna dhe ankthi, që prekin sidomos njerëzit e pafajshëm dhe vendet e kultit”.

Dëshmitarë të Ringjalljes

“Në lutjet tona – lexohet në tekst – kujtojmë edhe të gjitha gratë e fëmijët, që pësojnë dhunë e padrejtësi në gjithë botën. I ftojme të gjithë të respektojnë dinjitetin e çdo njeriu dhe të ecim së bashku drejt plotësisë e begatisë së jetës”. Duke përmendur fenë e të parëve në kumtin e engjëllit “Nuk është këtu. Është ringjallur...”, duke dëshmuar se Krishti e mundi vdekjen, Patriarkët dhe krerët e Kishave të Jeruzalemit i ftojnë “ndjekësit e krishterimit në gjithë botën dhe, në veçanti, popullin besimtar në Tokën Shenjte e në Lindjen e Mesme, të marrin forcë nga kremtimet e Pashkëve. Të gjithë ne – urojnë ata – qofshim dëshmitarë të ringjalljes, përmes promovimit të vlerave të Zotit tonë të Ringjallur, që është Udhë, e Vërteta dhe Jeta; përmes përfshirjes aktive në jetën e Kishës dhe të mbarë shoqërisë”.

Mesazhi mban firmën e 13 Patriarkëve dhe ipeshkvijve

Mesazhi mban firmën e 13 Patriarkëve dhe ipeshkvijve, ndër të cilët, Patriarku greko-ortodoks Teofil III, Administratori apostolik, imzot Pierbattista Pizzaballa i Patriarkatit latin të Jeruzalemit dhe Rojtari i Tokës Shenjte, atë Françesk Patton. Ata kujtojnë se me Pashkët e Krishtit, “fjalën e fundit nuk e ka vdekja, por Zoti i jetës”. Si besimtarë, theksojnë, “jemi të thirrur të ecim në jetën e ringjallur të Jezusit, jetë në begati, jo në skamje. Përmes jetës, vdekjes e ringjalljes së Tij, Jezusi i rikrijoi të gjitha gjërat... Festa e ringjalljes na kujton se dinjiteti njerëzor duhet respektuar e nderuar”. Njerëzit janë krijuar në shembëllim e në përngjasim me Zotin, prandaj janë të barabartë para Hyjit. Pashkët, përfundojnë Patriarkët e krerët e Kishave të Jeruzalemit, janë kohë, në të cilën kremtohet familja njerëzore në dritën dhe në begatinë hyjnore.



Don Lush GJERGJI

JEZUSI ËSHTË I GJALLË EDHE SOT*“Dhe, ja, unë jam me ju gjithmonë – deri në të sosur të botës!” (Mt 28, 20)*

“Ne duhet t'i lejojmë Zotit të mirë që të bëjë çdo projekt për të ardhmen, sepse dita e djeshme ka kaluar, e nesërmja nuk është ende, dhe ne kemi vetëm të sotmen, për ta bërë Atë të njohur, për ta dashur dhe shërbye”. (Nëna Tereze)

Jezusi, gjatë jetës së tij tokësore, pati shumë takime me njerëz të llojllojshëm, në rrethana të ndryshme. Madje, Ai ishte “ndeshur” me vuajtje, mjerim, sëmundje, mëkate, brendinë e njeriut, me vdekje, me atë që ne e quajmë tërësia komplekse – “njeriu”.

Shumë njerëz e dëgjonin, por pak kush e kuptonte deri në fund.

Shumë njerëz e kërkonin, por pak e gjenin.

Shumë ishin të tërhequr nga fjalët dhe veprat e tija, mirëpo pak kush kishte guxim t'i dorëzohej dhe të ecte pas tij.

Shumë mrekulloheshin, por pak kush zbulonte kuptim e vërtetë të mrekullive.

Shumë kishin nevojë për të, por vetëm për disa bëri

mrekulli, fali haptas mëkatet dhe i çliroi nga robëria e djallit.

Shumë shkuan me të, por pak ishin të zgjedhur, të ftuar: apostujt dhe nxënësit e tij.

Edhe sot:

Shumë thonë se besojnë, mirëpo ndoshta pak jetojnë në përputhshmëri me fenë ungjillore.

Shumë thonë uratë, mirëpo ndoshta pak dialogojnë me Zotin dhe me të afërmin.

Shumë marrin sakramentet, por, ndoshta vetëm disa bashkohen dhe jetojnë me Jezusin.

Shumë e kërkojnë, mirëpo pak e gjejnë... Pse?

Si atëherë, ashtu edhe sot, vetëm kush e kërkon me shumë fe dhe dashuri, me zemër të pastër dhe të singërtë, mund ta gjejë dhe jetojë me Jezusin, sepse “Vetëm kush lutet dhe dashuron me zemër të pastër mund ta gjejë Zotin.” (Nëna Tereze)

Për ta takuar sot Jezusin, nevojitet mbi të gjitha:

Njohja dhe gjetja e Jezusit në Bibël, sidomos në Besëlidhje të Re, në Ungjij, si fjalë e



jetës. “Kisha gjatë shekujve priret pareshtur drejt plotësisë së të vërtetës hyjnore, deri sa në të të plotësohen fjalët e Hyjit.” (DV 8)

Njohja në Kishë, mbi të gjitha në sakramente, sidomos në Eukaristi, ku Jezusi është realisht i pranishëm dhe veprues.

Njohja në të afërm, njeri, në rrethana të jetës. Pastaj, duhet ta njohim dhe pranojmë mëkatën tonë, kufizimet, ngarkesat, edhe më shumë, mëshirën, dashurinë dhe faljen e Zotit, me fe, shpresë dhe dashuri, sepse “Ne e njohëm dashurinë që Hyji ka kundrejt nesh dhe i besuam asaj. Hyji është Dashuri, dhe, kush mbetet në dashuri, mbetet në Hyjin dhe Hyji mbetet në të.” (1 Gjn 4, 16)

Jezusi, edhe sot është i gjallë dhe i pranishëm nëpërmjet Kishës, e cila vazhdon veprën e saj “për t’ua çuar shpëtimin të gjithë njerëzve duke qenë për këtë arsye e shtyrë prej detyrimit për të përhapur mesazhin ungjillor” (IM 3), “Kisha si sakrament të gjithëmbarshtëm të shpëtimit.” (LG 48)

Këtë e ka dashur dhe themeluar vet Jezu Krishti: “themeloi Kishën e vet si sakrament të shpëtimit dhe dërgoi apostujt e vet në mbarë botën, ashtu si edhe ai vetë ishte dërguar prej Atit” (AG 5).

Prandaj, Kisha, na ndihmon që të bashkohemi me Zotin dhe me të afërmin, sepse ajo zbulon dhe njëkohësisht realizon misterin e dashurisë së Hyjit ndaj të afërmit. (khs. LG 44)

Kisha i bashkon të gjithë popujt e botës në një Popull të ri të Zotit. “Hyji deshi që t’i shenjtërojë dhe t’i shpëtojë njerëzit jo individualisht dhe pa asnjëfarë lidhjeje mes tyre, por deshi të formonte prej tyre një popull, që të njihje Hyjin sipas së vërtetës dhe t’i shërbente atij me shenjtëri... I themeluar prej Krishtit për një bashkësi jete, dashurie dhe të vërtete, prej tij edhe është marrë që të jetë mjet i shëlbimit të të gjithëve dhe, si dritë e botës dhe kripa e tokës (khs. Mt 5, 13-16), është i dërguar në gjithë botën.” (LG 9)

Prania e Krishtit, nëpërmjet Kishës, realizohet sidomos në liturgji. “Për të realizuar një vepër kaq të madhe, Krishti është gjithmonë i pranishëm në Kishën e vet dhe, në mënyrë të veçantë, në veprimet liturgjike. Është i pranishëm në flinë e meshës, qoftë në personin e mbarështuesit, duke qenë ai vetë që, “pasi është kushtuar një herë në kryq”, e kushton përsëri vetveten nëpërmjet mbarështimit të meshtarëve, qoftë sidomos në dukjet eukaristike. Është i pranishëm me virtytin e vet në sakramentet, deri në atë pikë sa kur dikush pagëzon është vetë Krishti ai që pagëzon.” (SC 7)

Çdo njeri i çdo kohe, kulture, prejardhje, feje, shoqërie, race, gjinie, ka nevojë për Zotin gjithnjë, sot, ndoshta më tepër se kurrë, edhe pse kjo

nevojë shpesh nuk njihet dhe pranohet me apo pa vetëdije.

“Unë mendoj që njerëzit janë shumë më të uritur për Jezusin, sot, më shumë se në ndonjë kohë tjetër. Ata, kanë uri për bukë të përbashkët, por edhe uri për dashuri, mirësi, kujdes. Sidomos rinia ka etje dhe uri për të pafundësi. Ata shpesh nuk arrijnë ta shohin Zotin në ne. Dhe këtë fakt rinia nuk arrin ta pranojë. Ne diçka themi me gojë, ndërsa diçka tjetër jemi me jetë. Kjo gjë i largon prej nesh dhe është shkak kryesor i humbjeve të shumë thirrjeve, dhe për rrënimin e shumë tjerave... Rinia sot nuk dëshiron më vetëm të dëgjojë, por edhe të shohë... Ne ndoshta flasim shumë për Zotin, por ndoshta jetojmë pak me Të.” (Nëna Tereze)

Për ta njohur dhe jetuar sot Zotin, Kisha ka nevojë për shumë dëshmitarë burimor, të pranishëm në jetë të krishterë. “Duhet të jetojmë dhe dëshmojmë Ungjillin para tjerëve. Dëgjimi i Fjalës së Zotit me zemër të pastër në plotësinë e thellësisë së qenies tonë. Para se të shpallim, duhet të dëgjojmë, sepse Zoti flet në heshtje të zemrës tuaj... Sot, edhe një herë, kur Jezusi vjen ndër të vetët, ata nuk e njohin. Ai vjen në trupat e kalbur të të varfërve, vjen edhe nëpërmjet të pasurve, të zhytur në pasuritë e tyre. Ai vjen në vetminë e zemrave të tyre, atëherë kur s’ka askush për t’i dashur. Jezusi vjen edhe tek ju dhe tek unë, mirëpo shpesh, ne kalojmë pranë tij.” (Nëna Tereze)

Jezusi, është edhe sot i gjallë, i pranishëm në mënyra të ndryshme, mirëpo ne ndoshta nuk jemi të “aftë” dhe të gatshëm ta njohim, pranojmë, shërbejmë, dashurojmë në të tjerët.



Giandomenico MUCCI

NËSE BESIMI ËSHTË I DOBËT EDHE DYSHIMI ËSHTË I DOBËT

Disa vite më parë, Conrad Hackett, kryetar i ekipit, i cili ka publikuar dokumentin e “Pew Research Center”, mbi difuzionin e besimeve të ndryshme, i ka deklaruar Wall Treet Journal : « Nga 2015 në 2020, krishtërimi do t'i vuajë humbjet më të mëdha të njohura ndonjëherë, si rezultat i komunikimit ; përmes këtij procesi do të fitojë 5 milion virtyte, por do të humbë 13 milion; sidomos ato të grupit të njerëzve ateistë. »

Duke iu referuar Evropës ka thënë që në pjesën më të madhe të qyteteve, mes të cilave: Anglia, Gjermania dhe Italia, vdekja e të krishterëve e ka kalur shifrën e gjashtë milionëve, nga 2010 deri në 2015. Ky zvogëlim i popullsisë së krishterë, në një mënyrë të natyrshme në Evropën që vjetrohet, është unike në krahasim me pjesët tjera të botës. Popullsia e krishterë e Evropës, duhet të zvogëlohet me rreth 100 milion njerëz, në dekadat e ardhshme, duke kaluar nga 553 milionë në 2010 dhe në 454 milion në vitin 2050. Brenda 2050, gati një çerek i evropianëve (23%), nuk do të ketë asnjë përkatësi fetare.

Një e dhënë e tillë sociologjike, nuk është aspak këshilluese. Por padyshim, më shqetësuese është këmbëngulja në atë proces kulturor, që ka investuar botën besimtare dhe ka përfshirë, madje në masa të mëdha, sensin e mungesës së koherencës. I vetmi besim i perceptueshëm, është ai shekullori, i cili lidhet me humanitetin dhe progresin. Nga ana tjetër, termi i cili mbyll në vetvete të padukshmen dhe misterin, hijen dhe dritën, Zotin dhe perënditë, e padyshim fjalën, është zhdukur.

Gnostiku është qytetari i zakonshëm i shoqërisë së shekullarizuar. Nga ana tjetër e besimit shekullor, është dishepull dhe i krishterë, i cili ashtu si të gjithë jeton në një ambient, në të cilin Zoti është në mungesë. Dhe ky besim e ka përshkruar mirë shoqërinë perëndimore, ku vetë i krishteri, në mënyrë të pakapërcyeshme, beson se edhe ai po eksperimenton. E për aq kohë sa tentohet kaq shumë, mund të ndodhë që edhe vetë i krishteri të bindet që argumenti “Zot”, ose “besim”, është diçka shumë komplekse dhe kundër rrymës, dhe duhet të meritojë vetëm indiferencën. Në këtë jetë, bëhesh jobesimtar,



si pasojë e përtesës.

Përveç kësaj duket sikur po vepron një tjetër fakt, Camilles Riquier profesor në Insitutin katolik të Parisit, i detyrohemi për vëzhgimet që vijnë: “Tani, në fakt, që shkenca jonë dhe teknologjia jonë, zhvillojnë më shumë probleme sesa mund të zgjidhin, dhe që rënia e kolonializmit ka përfshirë të tjera kultura dhe besime, që mes të tjerave mbesin akoma të pranishme lind pyetja: A duhet të zhvillojnë prapë të njëjtin agnosticizëm, i cili mbizotëron në ditët e sotme? Gnostiku duket sikur po dorëzohet gjithnjë e më pak, ndonjëherë pendohet që nuk beson, madje ka aspiratë që të besojë, pastaj pranon që nuk mund ta bëjë dhe aktualisht kënaqet nga ky aspirim i tillë.”

Kështu, sot figura, e cila më shumë sesa të tjerat, akoma në kohën tonë shpesh secili gjen një rizgjim të brendshëm, i cili nuk është një frikë, por kjo ndjenjë është pikërisht ndjenja e të krishterit të ngrohtë, apo e gnostikut. Nëse besimi është i dobët, edhe dyshimi është i dobët.

Një mohim?

Nëse këto vëzhgime korrespondojnë me të vërtetën, do të thotë që i kthehemi pyetjes metafizike: Kush është njeriu dhe cili është kuptimi i jetës, i vuajtjes, i vdekjes, kuptimi i çdo gjëje që ai bën? Do të thotë edhe që vendoset ndryshe raporti besim-fe, ku besimi nuk është konsideruar më si një

hipotezë e pavlerë, ashtu siç kishin predikuar për gati dy shekuj: pozitivizmi, marksizmi, psikanaliza; të cilat e kishin përshkruar si një problem inekzistent i popullit, neurozë obsesive.

Nëse e percetojmë edhe një herë këtë pyetje, kishte pasur të drejtë Norberto Bobbio, kur pohonte: “Unë nuk konsiderohem një njeri i besimit. Konsiderohem një njeri i arsyes, nga një arsyetim i vogël, i vogël, i cili nuk ka të bëjë fare me absolutizmat tokësore.” Por ai është i hapur ndaj misterit, ashtu siç është një besimtar i zakonshëm. Dhe duket një mohim, parashikimi i Augusto Del Noce, i cili vinte re te nihilizmi, fatin e shoqërisë perëndimore, në të cilën kuptimi i asgjësë, e kishte zhytur në një mërzi, prej së cilës nuk mund të dalë askush. Njeriu perëndimor, mund ta bëjë të tijën, vetëm një sjellje utilitare dhe hedoniste.

Duket mohim edhe parashikimi i Max Weber, i mbajtur deri tani si modeli i Evropës bashkëkohore, që ka qenë qendra e procesit të shekullarizimit. Sipas tij, njeriu modern është njeriu faustian, i cili me vendosshmëri refuzon ngushëllimin fetar dhe e përballon jetën duke ndjekur të dhënat shkencore, edhe pse e dinte se ajo nuk mund ta çonte në asgjë përfundimtare. Atëherë, në çdo rast që t'i paraqitet njerëzve të këtij zhvillimi të shoqërisë, mund të jetë e vërtetë fjala: “Specialistë a inteligjentë, përfitues pa zemër; asnjë nuk e imagjinon që është ngritur në një shkallë të tillë humanizmi, që nuk e ka arritur asnjëherë më parë.” Teksti “profetizon” teknologjinë, nihilizmin, që e shikon shkencën eksperimentale si një përfundim të lehtë, por asnjëherë përfundimtar; besimin shekullor të njerëzimit, pa inteligjencën e sensit të të jetuarit e të të paguarit vetëm për kënaqësitë e tij individuale.

Profecia e Weber ruan akoma edhe sot, vlerën e tij të realizmit. Mendimi evropian, që profetizonte progresin si një ligj themeltar të historisë, i cili me idealizmin, e shikonte të garantuar forcën absolute të Shpirtit, të përfshirë në histori; dhe që me pozitivizmin, shikonte hirin e ligjit të evoluimit, e cila dominon natyrën dhe promovon jetën, zhvillimin e të gjitha qenieve të gjalla. Ajo shfaqet në cekëtinat e thata të teknologjisë, dhe është dënuar në një mënyrë të pandreqshme me një fat fatal. Në shumë vetë që mendojnë kështu vepron, mbase në një mënyrë të pavetëdijshme, sugjerimi i një të

dituri, Oswald Spengler.

Dhe ja, të dhënë inkujaruese të “gnostikut të ngrohtë”. Është një e dhënë inkujaruese pasi tregon se në historinë evropiane ka pasur dhe ka, devijime të errëta, vështirësi, të cilat, nuk autorizojnë të flasin për të vërtetë që do të sigurojnë atributimin e shoqërisë perëndimore. Nuk ekzistojnë fate fatale. Edhe ai, i cili nuk beson në një prejardhje që dominon historinë njerëzore dhe që e drejton paditurinë tonë, duhet të kujtojë rreziqet, vështirësitë, pengesat tashmë të kaluara, që gjithnjë shfaqen; por që nuk janë asnjëherë realiteti ynë përfundimtar. Pasi përmbajtja e shoqërisë, faktori i tij thelbësor është njeriu, i cili mund të shikojë me përgjegjshmërinë që rrjedh nga liria e tij: njeriu, i cili do të dijë të përdorë pozitivizmin e fitoreve të tij dhe që do ta kalojë ose rregullojë anën negative që nga ajo do të mund të dalë.

Në këtë rregull, na duket se duhet të bashkohet propozimi i Massimo Cacciari, i cili duke pasur parasysh sfidat e paraqitura nga modernizmi dhe nga teknologjia, rilexon mendimet e Romano Guardini mbi domosdoshmërinë që ka Evropa, të shtojë si supozim thelbësorë të së tashmes të tij, traditën e vet të krishterë dhe figurën e Krishtit. Jo vetëm bota klasike nuk mund të jetë sot e konceptuar pa meditim të krishterë, jo vetëm ideja e përfaqësimit që dominon ndërtimet politike evropiane ka një analogji të tijën me kompleksitetin e monoteizmit të krishterë, por edhe “Erlebnis” i shkencës evropiane zhvillohet nga shpirti i Annuncios së krishterë, të ekzistencializmit, që për këtë arsye hakmerret për përfundimin e ndodhive natyrore dhe historike.

Politeizmi i vlerave të vetë shoqërisë mund të përfaqësojë prologun e një paganizmi, më shumë sesa të rrezikshëm; një paganizëm i cili shprehet në kultin e një fuqie të vetme shpëtimtare, e kur në të bashkohen: Teknika, Fuqia politike, atëherë është thjesht ardhja e Anti-Krishtit. Është një fill; i cili lidh shpresën e një rizbulimi të rinovuar, nga rrënjët kristiane të Evropës me fenomenin e gnostikës së ngrohtë dhe nga nostalgjia e vet.

Material i përkthyer nga revista kulturore – fetare “La civiltà cattolica”, 2018.

Përktheu: Bernardina Shahini

Don Nosh GJOLAJ

KRIZA E IDENTITETIT SI MASHKULL DHE SI BABË

(pjesa e parë)

Kam mësuar nga një tregim i imagjinuar, që ndërlidhet me familjen, e cila është në krizë dhe babai ka mbetur mysafir në shtëpinë e vetë.



Familja e ketrave

Në një vrimë të në drurit jeton familja e ketrave (gjeri). Ushqimi ishte i thjeshtë, çerdhja po ashtu e varfër, por ata mes vete ishin në marrëveshje reciproke dhe si të tillë të fatlum dhe të gëzueshëm. Baba dhe nëna kishin kohë jo vetëm për njëri tjetrin por edhe për fëmijën e vetë që i donin aq shumë. Një ditë prej ditëve baba i ketrave i thotë bashkëshortes: “E dashura ime, nuk e di se sa keq ndjehem, kur të shoh ty dhe fëmijën në skam varfërie, në krahasim me banorët e tjerë të pyllit, që e kanë një jetë më të rehatshëm, banesën më të mirë dhe i ushqejnë fëmijën me ëmbëlsira, nuk mundesh të besosh se sa keq ndjehem dhe më shoqërojnë edhe ndjenjat e fajit, se sa babë i keq dhe i pakujdesshëm jam. Më duhet të bëjë diçka.”

Prej asaj dite baba i ketrave filloi të punojë më shumë. Nga mëngjesi i hershëm para drite shkon në pyll për të mbledhur pemët e llojllojshëm si edhe gogla. Në shtëpi kthehet shumë vonë të natës. Në mënyrë të përhershme e përsëritë: “Më duhet të punojë. Më duhet të jam i zellshëm si bleta. Çerdhja ime duhet të jetë më e mirë se e shqiponjës.”

Ashtu për çdo ditë nga mëngjesi i hershëm deri orët e vona të natës ai mbledh e mbledh pemë dhe

gogla. Ashtu duke dëshiruar familjes së vetë t’iu ofrojë më të mirën.

Po ashtu edhe jeta e tij ndryshoi. Radhitet në mesin më të pasurit të banorëve të pyllit. Vishet si mbretë, kurse në thellësinë e zemrës nuk ka asnjë farë kënaqësie. Dëshiron të ketë edhe më shumë. Në çerdhen e tij të bukur janë grua dhe fëmija të cilët jetojnë në një luks material. Asnjëherë nuk kanë pasur si tani. Banesa ishte më e madhja e më e bukura në atë pyll. Kurse ketrat e vogla (fëmija) ndjehen të vetmuara. Asnjëherë nuk kanë mund ta shohin babin, ta dëgjojnë zërin e tij, ta ndjenjë ngrohtësinë e prekjes dhe të ledhatimit. Gjithherë është jashtë, për të fituar sa më shumë të mira materiale.

Një ditë fëmija më i vogël e pyet maminë: “Mami ku është babai? Asnjëherë ai nuk është në shtëpi! Ashtu jemi të vetmuar! Pse nuk kujdesohet ai për neve?”

Nëna e kthen kokën në njërin anë dhe i mbushën sytë me lot dhe i përgjigjet: “Jo, jo! Babi neve na do shumë. Punon shumë, për t’u kujdesuar për neve që ta kemi përherë ushqimin më të mirë, ta kemi lodrat më të mira, bile ta kemi internetin dhe e-phonin. Ai na e dëshiron më të mirë gjë.”

Por, fëmija tjerë një zëri reagojnë: “mami ne e duam babin ta kemi të pranishëm në mesin tonë.

Dëshirojmë ta shohim, ta dëgjojmë se çfarë zërit ka, të lozim me të. Pa të ndjena të vetmuar, ai na mungon shumë.”

Kur kthehet babi të njëjtë natë orët e vona të natës në shtëpi, bashkëshortja nuk mund të heshtin por i thotë: “I dashuri imë, ne të gjithë ndjehemi të vetmuar. Po ashtu edhe fëmija ndjehet të vetmuar. Nuk ndjemë se na do dhe kujdesohesh për neve. Kemi nevojën tënde. Dëshirojmë dashurinë tënde, veçanti fëmija këtë e duan. Ne nuk kemi nevojë për pasurinë materiale dhe lukse por kemi nevojën dhe praninë tënde!”

Babit nuk i pëlqyen fjalët e bashkëshortes. Hidhërohet dhe bërtet: “Çka po thua? Se unë nuk të dua? A nuk sheh se punojë deri në djersën e fundit për juve? Dëshiroj t’iu sigurojmë më të bukurën banesë, më të mirin ushqim, më të bukurat veshje. Gjithçka më të mirë dhe më të bukur, dhe ti merr guxim dhe më thuash se unë nuk ju dua! Për kë unë gjithë këtë e bëj? Sa falënderuese jini!” Bashkëshortja e qetë i përgjigjet: “Fëmija nuk kanë nevojë për një shtëpi të madhe, por një shtëpi të ngrohtë! Ne nuk kemi nevojë aq për pasuri materiale, për ushqim, luks. Unë dua burrin dhe fëmija e duan babën që të jetë në mesin e tyre. A mundesh të thuash se zemrat tona nuk janë uritura?”

Babi i hutuar dhe i hidhëruar përgjigjet: “Vërtetë gratë gjë nuk kuptojnë dhe nuk marrin veshë? Gjithherë duanë dashuri vetëm dashuri. Nuk e kuptojnë se në botën e sotme nuk jetohej vetëm prej dashurisë dhe vëmendjes? Dëshiroj që t’iu mundësoj të ardhmen, sigurinë dhe jetën pa brenge...”

Shamatë në mes burrit dhe gruas i zgjojnë fëmijët prej gjumit. Këtë radhë më i vogëli për herën e parë e sheh babën.

Fëmija i madh ju thotë: “Ky njeri punon shumë dhe na ka ble gjithçka që kemi në shtëpi.”

Kurse fëmija më i vogëli në mënyrë të pafajshëm i thotë: “Thuaji këtij njeriut, të na blejnë edhe një babë!”

Në epokën tonë janë vërejtur ndryshime të shpejta në zakonet dhe jetën në përgjithësi, veçanërisht në jetën e çiftit martesor. Në dhjetëvjeçarët e fundit kanë ndodhur ndryshime strukturore të familjes, si në funksion ashtu edhe në rolin e saj. Shembull për këtë janë kalim nga një familje patriarkale – molekulare – e zgjeruar, në një familje bashkëshortore – njëqelizore – e ngushtë, rënia e përqindjes së martesave, shtimi i divorceve dhe ndarjeve, shtimi i numrit të çifteve që bashkëjetojnë.

Me gojë plotë mund të themi sot se roli dhe statusi i mashkullit si babë është në krizë dhe mos të themi në shkatërrimin e epërm!

Dashuria e burrit ndaj bashkëshortes së vet e cila



bëhet edhe nënë edhe gjithashtu dashuria ndaj fëmijës, është ajo rruga e natyrshme, që e drejton identitetin e mashkullit kah realizimin ose aktualizimin e mashkullit si babë.

Por sot është roli dhe statusi i mashkullit si babë në krizë.

Në mënyrë telegrafike ta shohim historinë dhe rolin, tipin e mashkullit si babë gjatë historisë të njerëzimit.

1. Tipi dhe roli i babës gjatë historisë

Ideologjia komuniste ka fundi i shekullit të XIX dhe në shekullin XX është orvatur ta zbejë dhe ta eliminoj familjen si të tillë. Sepse për ideologjinë në fjalë ishte familja ajo që i pengonte mirëmbajtjen dhe frymën e shpirtit revolucionar. Për qëllimet e tilla ideologjia komuniste është munduar ta gjejë arsyet e veta në shoqërinë primitive të njeriut, gjoja se te kjo shoqëri ishte seksi i barabartë në mes të mashkullit dhe të femrës, ndërsa fëmijët i ka edukuar vet fisi. Ndërsa historia i njeh disa shembuj të familjes, që e kishin lidhje labile, si për shembull:

- Një fis prej Indie i quajtur NAYAR. Përpara ardhjes kolonizatorit anglez, në këtë fis nuk kishte familje në vështrimin e fjalës që e kemi ne sot. Meshkujt gjatë natës i vizitojnë grat, ndërsa fëmija që lindin ishin të nënës.

- Një fis tjetër Ashtanti në Ganën qendrore të Afrikës. Mashkulli dhe femra jetojnë të ndamë nëpër kasolle. Fëmija e bartin ushqimin prej kasolles së

femrës në kasollen e mashkullit, dhe ata mund të ushqehen bashkë me meshkuj. Meshkujt gjatë natës i vizitojnë femrat dhe flejë me to. Gjersa baba e ka të kufizuar rolin edukues ndaj fëmijës.

Edhe sot në kohën moderne, mundohen disa lëvizje, që ta krijojnë një bashkësi familjare në të cilën baba nuk ka rolin e vet si babë. Siç janë Kibucët në Izrael. Aty familja është reduktuar vetëm mashkull dhe femër (burrë - grua), ndërsa kujdesin për edukimin e fëmijës e merr mbi vete bashkësia në tërësi.

Tipi i dytë i eksperimentit modern janë “komunat” ashtu të quajtur. Aty jetojnë si mashkullit dhe femrat bashkë dhe janë të barabartë, dëshirojnë ta imitojnë natyrën. Jetojnë me natyrë dhe për natyrë, dhe i kanë shkundë të gjitha paragjykimet që janë krijuar gjatë historisë të njeriut. Komunitet e tilla e kanë zbe obligimet e martesës, traditën, religjionin, fenë, ritualet dhe me një fjalë formën e jetës. Gjithkush në komune e zgjedh partnerin sipas dëshirës së vet, fëmijë e edukon bashkësia e komunës, sepse dyshojnë dhe nuk ja lejojnë shtetit as shoqërisë ta edukojnë dhe të kenë ndikim në fëmijën e tyre!

a) Tipi dhe roli i babës gjatë shoqërisë primitive

Me këtë nocionin “shoqëria primitive”, mendojmë në shoqërinë e parë e cila ishte para se fillon të lajmërohet shkrimi, para dokumenteve të shkruara. Për këtë tip shoqërie, që është shumë i varur prej klanit ose të fisit, ku mbretëronte jeta



fisnore. Familja si e tillë ishte shumë e fort edhe e lidhur shumë ffish me fisin ose klanin që i takonte. Antropologu i njohur Raymond Firth, i cili ka hulumtuar fiset e Polinezisë të ishullit Tikopia (R. Firth, We, The Tikopia, Londër 1936). Thotë: mashkulli e grabit vajzën prej shtëpisë, pa e lajmëruar, në mënyrë tinëzake ose befasishme. Pas që ajo mbetet shtatzënë, atëherë publikisht dhe zyrtarisht njihet si familje, edhe pse te ky fis nuk ka ritual të martese. Gjatë kohës së shtatzënisë, mashkullin nuk e obligonë besnikëria ndaj bashkëshortë, dhe ai si i tillë shkon me tjera femra. Me lindjen e fëmijës, themelohet familja. Aty ku jetojnë dy ose tri familje nën një kulm, atëherë çdo familje e ka vendin e vet për jetën private. Kërkohej besnikëria e ndërsjellë. Aty vërehen edhe shenjat e xhelozisë. Por ka edhe hakmarrje për çështjen e dashurisë. Burri dhe gruaja shkojnë ë bashku në punë, në kopsht dhe së bashku kthehen në shtëpi dhe ashtu së bashku e përgatisin ushqimin. Punët e tjera i punojnë të ndamë, veçmas burri dhe veçmas gruaja, por të mirat së bashku i shfrytëzojnë. Sipas principit mashkulli është kryetari i shtëpisë, sepse e trashëgon prej babës pronën dhe truallin e shtëpisë. Por praktikisht çdo partner kujdesohet për sektorin e jetës së përbashkët. Gruaja është e mbrojtur, ashtu që ajo në çdo lloj kohet mund të kthehet te baba i vet, në qoftë se nuk mund ta durojnë dhunën dhe pa drejtësinë, që ja bënë burri. Gjithashtu gruaja kujdesohet për foshnjën e posa të lindur, dhe asaj i ndihmojnë edhe gratë e shtëpisë së burrit. Pas disa javës pritet që edhe baba të kyçet për rreth fëmijës. Ashtu edhe për fëmijët, që janë të rritur janë të obliguar, edhe ata vet të kujdesohen për vëllezërit dhe motrat e vegjël. Kur fëmija rritet, zakonisht djali do ta ndjek rrugën e babës, ndërsa vajza rrugën e nënës. Fëmijët i mësojnë, që t'i respektojnë të vjetërit. Metodat pedagogjike nuk janë të ashpra, fëmija ka mundësi me kërkuar strehim te kushërit e vet, deri sa furtuna e shtëpisë nuk qetësohet. Djali i madh po sa të martohet e lëshon shtëpinë e babës, ndërsa shtëpia i përket më të voglit, dhe ai do të kujdesohet për prindërit e vet. Në jetën e përditshme, baba e ka autoritetin e vet. Detyra që e ka baba, është kujdesimi për mirëmbajtjen e familjes, posaçërisht çka i përket ushqimit dhe veshmbathjen, edhe i mbron fëmijët e vet prej çdo sulmit derisa ata janë të vegjël.

Me një fjalë baba e ka vendin e vet të caktuar, gjithashtu edhe statusin dhe rolin e vet. Baba i tillë zakonisht nuk është tipit diktator, por bashkëpunon me bashkëshortin e vet në mënyrë të sinqertë, duke kujdesuar për mirëmbajtjen e familjes.


Xhonti BARDHI

BOTËKUPTIMI I SHKENCËS POZITIVISTE MBI NJERIUN NË MENDIMIN E EDMUND HUSSERL-IT

Apologji; raporti, Fe dhe arsye (shkencore)

Përsa i përket kësaj trajtese lidhur me këndvështrimin pozitivist mbi shkencën dhe shumë aspekte të tjera njerëzore do ti referohem më së shumti këndvështrimit të Edmund Husserlit, filozof dhe mendimtar i madh, për nga natyra e formimit filozof-fenomenolog, i cili analizon dhe hedh dritë mbi disa çështje apo probleme do të thoja me të vërtetë të mëdha edhe shumë aktuale edhe sot. Njëri ndër problemet që kishin çuar në krizë shkencat europiane, që sipas tij ishte problemi kryesor, ai i pozitivizmit; fenomen i ashtuquajtur prej “babait të pozitivizmit”, Komte, si procesi i tretë i evolucionit të historisë, pas atij teologjik\metafizik dhe atij filozofik. Pozitivizmi sipas Komte ishte një proces i nevojshëm i historisë dhe në thelb përmban besimin e patundur në shkencë, këtë të fundit si të vetmen rrugë për njohjen e të vërtetave me anë të metodës së eksperimentimit shkencor, si dhe zhvillimin e njeriut, duke e vendosur këtë të fundit në boshtin e botës duke devijuar në formë antropocentrizmi të ekzagjeruar. Por pavarësisht kësaj elozhe të pozitivizmit, Husserl, prapëseprapë e konsideron atë si koncept mbetës. Po përse Husserl e konsideron si të tillë? Besoj se arsyet kanë qenë të shumta,

Kur fola për pozitivizmin jo pa qëllim lashë pa përmendur këtë këndvështrim, apo do të thoja problem me të vërtetë serioz, sepse duhet theksuar fakti se njeriu nuk është objekt, nuk është një mjet i rëndomtë i shkencës, njeriu për natyrë nuk është skllav i saj. Pozitivizmi i heq njeriut gjithë dinjitetin dhe identitetin e tij, nësa qenie njerëzore i heq atë dimension që për shumë filozofë përgjatë evolimit filozofik ishte quajtur si kafshë racionale, qenie metafizike, qenie shpirtërore dhe duke pasur parasysh se për secilën nga këto fjalë, ka një background që do ta quaja natyror dhe me të vërtetë objektiv, të dukshëm. Një tjetër çështje që ngre Husserl është arsyeja, ajo e cila për një periudhë të gjatë është gjendur mes “dy zjarresh”; atë pozitivist dhe atë metafizik. Por lind pyetja, njeriu a qenka i ndarë? A është vetëm materie (duke patur parasysh materializmin dialektik)? A është vetëm qenie metafizike? Këto pyetje, mua por besoj se edhe shumë të tjerë, do të na çonin në një rrugë të ndërmjetme, se njeriu me të vërtetë është subjekt shkencor (materie, i vdekshëm, i kufizuar në trup) por ama ai është edhe qenie metafizike (shpirt i pavdekshëm, jashtë kohës etj.) Problemi është,



arsyeja jonë me çfarë ushqehet?! A e ushqejmë atë ekstremisht djathtas apo majtas, apo ka një rrugë të ndërmjetme; arsyeja me të vërtetë qenka bartëse problemesh. Ashtu siç mirë e dimë se ekstremet për arsyen janë me të vërtetë problem, pasi ajo nuk mund të identifikohet duke u kufizuar vetëm në një kah, pasi ajo mbart probleme universale.

Ashtu siç e dimë, përgjatë historisë, filozofia është avaritur mes këtyre dikotomive; njeriu me prejardhje materiale dhe njeriu me prejardhje shpirtërore. Njeriu për natyrë është materie, por mbi të gjitha është edhe shpirt, pasi në të janë të skalitura dhe assesi nuk mund të hiqen disa dimensione tipike të tij si, Autotrashendence, Zoti, Liria, Pavdekësia e shpirtit (tre te fundit të marra nga Kant në Kritikën e arsyes praktike të konsideruara prej tij si postulate). Po si ka mundësi, do të thoshte Dekarti, që në mua, që jam një gjë menduese dhe e kufizuar, të jetë ideja apo dëshira për të pafundmen, për përjetësinë, për Zotin?! Këto të tria, Zoti, Liria dhe Pavdekësia e Shpirtit, duket sikur janë një apologji njerëzore-kristiane, kundër ekstremizmit shkencor, i cili do që ta shkëpusë njeriun prej këtyre të triave apo si të thuash prej identitetit të tij. Por lind pyetja, si shpërbëhet identiteti i njeriut? Nëse shpërbëhet, a paska qenë një identitet i rremë dhe tjetërsues? Por nëse jo atëherë pse ndodh ky fenomen i tillë? Unë do të thoja që kjo është fryt i atyre mendimtarëve që nuk e kuptojnë se çfarë do të thotë të kesh një qëllim një jetë, i cili e përfshin njeriun në totalitet dhe unitet por edhe i atyre që dimensionin teleologjik të natyrës as që e marrin për bazë, sepse, nuk është e mundur që objekte dhe dukuri natyrore, të cilat janë të privuara nga inteligjenca, të kryejnë funksionin apo qëllimin e tyre sikur ta kishin këtë të fundit dhe të mos e kenë marrë apo të mos e ketë vendosur këtë ligj një inteligjencë supreme që ne e quajmë Zot. Njeriu për natyrë rationale kërkon një qëllim në jetë, një qëllim që e plotëson, ndodh kështu sepse arsyeja vetë e kërkon atë. Qëllimi i njeriut, nëse do të ishte i këtij mentaliteti (pozitivist) nuk do ta plotësonte atë, pasi për

natyrë është i prirur drejt të pafundmes, por nëse qëllimi do të ishte i prirur drejt të pafundmes, arsyeja në të njëjtën kohë nuk e njeh, nuk e kupton pafundësinë sepse është e limituar njëkohësisht, rrjedhimisht duke krijuar një “pengesë” drejt saj. Pikërisht për këtë çështje nevojitet feja, besimi për të bërë të mundur këtë kalim këtë hap. Në lidhje me këtë Paskal thotë diçka shumë interesante; “basti”, i cili e ndihmon njeriun për të bërë këtë hap dhe hapje ndaj të pafundmes që futet në njeriun.

Duke u nisur nga çfarë shkrova më lart dhe duke parë realitetin e sotëm njerëzor, mund të duket e pakuptimtë. E pakuptimtë por ama me një shpresë të vetme që Ai që na e dha lirinë, që na e dha edhe praninë e Tij, që na e dha edhe pavdekësinë e shpirtit, por edhe shumë gjëra të tjera e sheh realitetin e sotëm të njeriut, pasi ata njerëz me pretendimin që ti zvogëlonin problemet njerëzore, i kanë shtuar edhe më tepër. Një problem konkret i sotëm, pikërisht prej këtyre zhvillimeve është indiferenca, mbyllja në vetvete, mbyllja ndaj të tjerëve, mbyllja ndaj vlerave dhe idealeve trashendente, mbyllja praktikisht ndaj shpirtërores, nga ku zë fill fenomeni i robotizimit, teoritë Gjender, lufrat, masakrat, kampet e ndryshme të përqendrimit, duke përfshirë këtu të gjitha eksperimentet çnjerëzore që janë zhvilluar në to, aborti e shumë të tjera që kanë ardhur pikërisht nga kjo harresë e Zotit. Kjo brezni ka nevojë të kthehet te Zoti, të vendoset përballë Tij në dëgjim, në mënyrë që të hapen sytë e mjegulluar e të shikojmë pafundësinë, të shikojmë gëzimin dhe lumturinë e vërtetë që vjen vetëm prej Zotit i cili u bë njeri sikur ne në personin e Jezu Krishtit.



Mërgim KORÇA

HISTORIA DHE MUSTAFA MERLIKA KRUJA

(Pjesa e dytë)

(Komente rreth Letërkëmbimit Mustafa Kruja – Patër Paulin Margjokaj)

Me që Padreja kërkon thellim, M.Kruja nuk përton dhe ia plotëson dëshirën. Kësisoj, përgjatë shpjegimeve dhe analizave që bën, (Fq.77-78), me një stil konçiz, elegant por edhe gjithëshpjegues, bën radiografinë e Fan Nolit nga ana shoqërore, vlerave të mëdha intelektuale si edhe figurës si politikan. Dhe jo vetëm kaq, por ve në dukje edhe burrërinë e tij tek rikujton se si, ndonëse Luigj Gurakuqi i lojti të gjitha kartat që Imzot Noli mos të emërohej kryeministër, ky i fundit jo që e mposhti egoizmin duke e emëruar Gurakuqin ministër financash, por, siç e citon tekstualisht M.Kruja, kur Faik Konica do t'a përbaltë Nolin duke shkruar në Gazetën Dielli, mbas ardhjes në fuqi të Zogut, se Noli qe bërë vegël si edhe kukull në duart e Gurakuqit, Noli përgjigjet gjithë modesti edhe madhështi njëherësh "... edhe në qofsha bâmë vegël e një Luigj Gurakuqit, siç thotë Faiku, kjo gjë s'do të ishte veçse një nderë për mue."

Pa le se si e përshkruan M.Kruja me penën e tij të fortë, po n'ato faqe, ngjarjen rreth takimit të Mussolinit me përfaqësuesin e Shqipërisë në Romë, Tefik Mborjen. Rreth bisedës tyre tepër sekrete, ku Mussolini këmbëngul mos të dilte asnjë fjalë se ndryshe do t'i quante të pabërë propozimet e tij, brënda tri ditësh biseda mori dhënë kafeneve të Tiranës. E M.Kruja intuitivisht merr pozicion duke i dalë zot T.Mborjes se veç kryeministrit Noli, Mustafa nuk besonte se Tefiku mund të kishte informuar as pjestarët e qeverisë. Por nga ana tjetër hedh dritë mbi rrethanat duke u shprehur "... sigurisht sekretarët e tij, miqtë e tyne e të vet sigurisht po ... fati i qeverisë së Fan Nolit ishte caktue qyshë prej atij çasti."

Nuk mund të lihet pa u përmendur përgjigja e fratit françeskan, sepse në përgjigjen e tij lidhur me F.Nolin, do t'a shohin veten shumë lexues të këtyre radhëve. "Letra e juej është një minierë njoftimesh fort të randsishme. Kta mund të thohet tashmë për të tana letrat t'Ueja. Përshkrimi i jetës së Fan Nolit më ka interesue fort. Me u diftue të drejtën, përpara kësaj letre e kam gjykue Fan Nolin krejt ndryshej. Un nuk dijshe kurrëja tjetër për te, veç se ai është mik i Rusve, e kjo më shtynte mue me formue një



gjykim jo aq të favorshëm për te." Ndonëse Padreja e njihte mirë anën intelektuale të Imzot Nolit, duhet theksuar se sa i takon anës politike sa keq kishte ndikuar mosnjohja nga ana e tij e personalitetit të Nolit, mbetur deri atëherë në errësirë.

Është qartë se, po të mos ishin intriguese pyetjet që i drejtonte Padreja M.Krujës, letërkëmbimi do të kishte zgjatur jo më shumë se tri letra të ndërsjella. Por ishin pyetjet e françeskanit të atij niveli që ia ngacmonin fantazinë edhe M.Krujës të zgjatej me to. Rezultati ? Kemi para nesh një letërkëmbim hiç më të vogël po prej 123 letrash të ndërsjella. E përgjatë kësaj vazhde, në letrën me nr. 31, Padreja shtron pyetjen madhore " Po t'u vëte një i huej e me të shá tue të përmendun punën e gjakut në Shqypni, (vendetta, ose Blutrache), shka kishi e si kishi me i përgjegjë Ju atij ? Trajtimi i problemit të gjakmarrjes nga ana e M.Krujës, (Fq.106-107-108-109), ndonëse zhvilluar fare shkurt prej tij, pa as më të voglën mëdyshje, është një leksjon i mirëfilltë akademik ku ai gërsheton këndvështrimin juridik teorik, (si duhet konsideruar nga shoqëria e

organizuar në shtet), me filozofin'e të gjykuarit të kësaj forme barbare të shpagimit, që e sintetizon në mënyrë konçize : “... parimin e drejtsis s'ka bir robi në botë qi t'a mohojë e qi, kur kjo s'i bie krës së vet, të mos t'a dishrojë e mos t'a kërkojë me kâmbëngulje e me zâ të naltë ... Ndër shoqnít qi e kanë kapërcye kamot atë fazë drejtsije, kërset shkandulli (skandali). E në vazhdim trajtohet me një kompetencë të lartë shkencore edhe problemi i parë nga këndvështrimi i besimeve fetare ku M.Kruja shtjellon kthimin e shoqërisë Ilire pagane në fen'e krishterë e cila mbeti sipërfaqësore. E mbi këtë nënshtresë pagane “ erdh shqizma e Shqipnija u ndodh shí në kufi të Okcidentit e t'Orjentit ku s'prâni lufta fetare ndërmjet këtyne dyve deri në ditën qi i a mbërrini Tyrku me një fé tjetër. Kështu qi ndërgjegja fetare e popullit t'onë, pa qenë formue ende mirë, u pështjellue e u bâ lamsh. Anarqija morale vazhdoi e një pushtet i fortë s'u themelue kurrë në vëndin t'onë. Prandej zakonet e vjetra, me të mirat e të këqijat bashkë, mbetën gjallë. Ndër ta edhe ndiesija e shpagimit të gjakut.” Gjithashtu M.Kruja shpjegon se si këto zakone e kanë rrënjën kush e di sa mijë vjet para Lekë Dukagjinit.

I gjithë trupi i vëllimit me letërkëmbimin ndërmjet M.Krujës dhe Patër P.Margjokajt, përshkohet pandërprerë nga një mësim etike dhe morali niveli të lartë kur është fjala lidhur me të vërtetat historike. Padreja i kërkon M.Krujës hollësira rreth delegatëve në Kongresin e Paqës në Paris si Patër Gjergj Fishtës si edhe Imzot Luigj Bumçit. Do sqarime të hollësishme rreth Kongresit të Lushnjes, etj.etj. Pa dashur t'ia shuajë aspak kërshërinë lexuesit të këtyre radhëve duke u zgjeruar rreth përgjigjeve që i dha M.Kruja Atit françeskan, duke ia lënë kësioji lexuesit të plotë kënaqësinë e të lexuarit të vëllimit të botuar, do të ndalem vetëm në disa momente kulmore që e ndjej të nevojëshme t'i nënvizoj. M.Kruja pohon dhe ripohon vazhdimisht se të dëshmuarit si edhe dhënja e gjykimeve rreth faktesh e rrethanash historike e ballafaqojnë studjuesin me vështirësi shkalle sipërore (Fq.161 deri 173). E këto ai i sheh akoma më të theksuara tek i duhet t'ia fillojë me autobiografin'e tij, para Padres. Nuk mund të mos vihen në dukje, përgjatë kësaj hullije, disa momente kulmore që kanë të bëjnë me karakterin e M.Krujës. Princ Wiedi ishte larguar. Esat Pashë Toptani e kishte vendosur pushtetin e tij dhe i kishte burgosur

të gjithë meshkujt Merlikas, përfshirë edhe të atin e M.Krujës. E sikur nuk mjaftonte me kaq, por burgosi edhe xhaxhan'e Mustafës, të famëshmin Xhiun e Fajës që kishte vrarë mu në Stamboll, tek Ura e Gallatës, të birin e vetë Vezirit të Madh të Turqisë. Në ato rrethana Esat Pasha lëshon një urdhër që, po të mos dorëzohej M.Kruja, të gjithë burrat Merlikas do të vareshin. Lind natyrshëm pyetja se ku e kishte shkelur në kallo M.Kruja Esat Pashën që ai të vepronte me aq armiqësi? Kur Pashai e kishte kërkuar bashkëpunimin e M.Krujës, ky i qe përgjigjur me shkrim: “ Juve ju ka falë Perëndija një emën të madh e një kambë të naltë, páre edhe gjâ; un s'kam veçse një nderë, po t'a humb edhe këtë, s'më jet mâ kurrëgjâ tjetër!” Ky refuzim i prerë i M.Krujës e kishte mbushur kupën e prandaj edhe Esat Pasha i vendosi atë kusht madhor alternativ M.Krujës. E Mustafa ç'bëri? Vete e dorëzohet me këmbët e veta. Tek e sheh në burg i ungji, Xhiu i Fajës dhe mëson se ai qe dorëzuar që të liroheshin Merlikasit e tjerë u hidhërua keq dhe tha: “Paj flaka t'i kish mbërrimë në kupë të qiellit krejt familjes me sa ka e ça ka, veç ty mos të të shihshem këtu!”. Situata qe e rëndë. E.Pasha kishte varur në litar gjithë rebelët që mbas ikjes Princ Wiedit nuk ishin bashkuar me të. Kështu që veç kob pritej nga ai. Kurse, të nesërmen e vetdorëzimit të M.Krujës, gjithë burrat Merlikas u kthyen të lirë në vatrat e tyre. Le këta, por në vazhdim, jo që nuk e vari M.Krujën por edhe së bashku me 300 të burgosur të tjerë, mbas gjashtë muajsh kur pushteti i E.Pashës u lëkund, i ngarkoi në anije dhe i dërgoi në burgun e Barit. Vazhdimi është histori dhe lexuesi do t'a mësojë kur t'a lexojë gjithë vëllimin me letërkëmbime, por për t'u ndalur dhe nënvizuar janë dy momente. I pari, se si M.Kruja me ndershmërinë dhe drejtësinë që e karakterizon, rikujton faktin historik duke pohuar se si fjalën e dhënë Esat Pasha e mbajti : me t'u dorëzuar Mustafa, burrat Merlikas u liruan nga burg. E pastaj vjen pohimi i dytë i M.Krujës që për armikun e tij pohon: Me mue u suell burrë (e ka fjalën për E.Pashën). Rebelët e zakonshëm i kishte varur në litar, ndërsa M.Krujën, jo. E M.Kruja e thellon gjykimin gjithmonë në favorin e armikut të tij duke shtuar ... Nuk bâni asnjânën prej dy anve të dilemës qi kishem drashtun un. Shërbimet qi i kishte bâmë familj'e ime s'i kishte harruem.

I kërkoj tashti ndjesë lexuesit por nuk mundem

të hesht pa e bërë një përjasje. Të krahasohet mirënjohja e E.Pashës ndaj Merlikasve me qëndrimin e mbajtur nga Enver Hoxha jo vetëm ndaj mirëbërësve të tij ku miqtë e ngushtë i pushkatoi, por edhe ndaj atyre që duke rrezikuar kokat e tyre i kishin shpëtuar jetën atij gjatë luftës si edhe e kishin mbështetur diktatorin në vazhdim. Në këtë kontekst binomi E.Pashë – E.Hoxhë.

Nga ana tjetër pastaj marrim binomin M.Kruja – E.Hoxha. Si i pohon të vërtetat M.Kruja për E.Pashën e si i shtrembëron të vërtetat E.Hoxha për tërë viktimat e tija ku bukëdhënësit bëhen armiq kurse heronjtë bëhen herë tradhëtarë të atdheut e herë poliagjentë.

I gjithi ky material shtjellohet në letrën me nr. 49 të M.Kruijes. E Padreja, duke e lexuar të gjithë atë letër me vëmendjen më të madhe e duke patur parasysh qëndrimin e M.Kruijes se si ai trembet se mos duke i trajtuar faktet historike mos nuk është skajshmërisht i drejtë ndaj vlerave të kundërshtarëve politikë të tij, Padreja pohon e thotë në letrën me nr. 50 ... Njerzt, qi nuk shofin veçse deri sa t'u mbërrijë maja e hundës, më vonë, edhe ata kanë me e justifikue veprimin t'Ând politik ... Shqypnija e shkretë në periudhën ndërmjet dy luftave nuk ka pasë tjetër alternativë, posë asaj: Itali-Jugosllavi ...

Padreja, në vazhdim, i bën edhe një analizë tamam radiologjike vetë popullit tonë. Ai e sheh si të keqe të madhe dembelizmin e tij, egoizmin, mosmbajtjen e fjalës së dhënë, të mos kuptuarit se vjedhja e shtetit është po aq e dëmshme sa edhe vjedhja e pronës së privatit, etj. etj. dhe përfundon me pohimin se ... Mkatë më i madh i shqyptarit, mbas mendimit t'em, është ky : na e mbajmë vehten për dishka. Po t'i njihshim na mungesët e mdhaja t'onat, kishin me shkue shum punë fort më mirë se shkojn ...

Letra me nr. 51, ku M.Kruja përshkruan gjëndjen e tensionuar të fund vitit 1918 e në vazhdim, e gjithashtu sqaron se si duke përgatitur materialet për delegacionin e Konferencës së Paqës të Parisit, gjatë 4-5 muajve pune gjithëditore së bashku me Luigi Gurakuqin, ata të dy nuk kanë ditur se ç'ishte e si ishte Parisi, duke i përshkruar në një mënyrë tejet bindëse rreziqet që i kanoseshin vëndit tonë nga qëndrimet shoviniste, i ve kapak me pohimin madhor konkluziv ... Çë çase

trishtimi e dëshprimi kemi kalue n'at Paris ... 800.000 bajonetat e mobilizue me t'Austro-Hungaris në 1913 për me shpëtue qytetin e Shkodrës, tash s'ishin më. Italia mbahej në konferencën e paqës për njëj traktat që shënonte dekën e Shqipnis ... Franca përkrahte miqt e vet qi ishin anmiqt t'anë. Anglija, si gjithmonë kur s'luejnë interesa direkte të saja, kishte për ligjë oportunitetin. Wilsoni mjedis dhelpnave plaka t'Evropës i kishte harrue 14 pikat e tija. Me ç'vërtyt do të bájshim mrekulli na të shkretët në këtë lāmsh pasjonesh e padrejtsish ...

Vetëm nëntë janë faqet e kësaj letre. Por ato nëntë faqe hedhin dritë të madhe rreth zhvillimeve të asaj kohe si edhe ndikimeve ndaj së ardhmes së vëndit tonë.



Leonora LAÇI

NJË LIBËR PËR ABATIN E MIRDITËS, IMZOT FRANO GJININ- MARTIR I KISHËS KATOLIKE

“Rrnoft Krishti Mbret! Rrnoft feja katolike dhe katolikët në botë! Rrnoft Papa! Gjaku dhe trupi jem mbeten këtu, por shpirti dhe zemra asht te Papa. Rrnoft Shqipnija!” - Këto kanë qenë fjalët e Abatit të fundit të Mirditës imzot Frano Gjinit, para togës së zezë të pushkatimit, më 11 mars të vitit 1948.

Tashmë lexuesit do të kenë në dorë një libër historik, me dokumente arkivore: *“Abati i Mirditës- imzot Frano Gjini. Martiri i kishës katolike.”*

Vepra në fjalë me rreth 310 faqe, është shkruar mbas hulumtimeve shumë vjeçare në arkiva, nga bashkautorët studiuesit Tomë Mrijaj nga New York-u dhe Leonora Laçi nga Shkodra.

Ky libër është një përpjekje serioze për të sjellë para opinionit shqiptar për herë të parë të dhëna arkivore, familjare, dëshmi, faksimile, kujtime, dorëshkrime, letra, procesverbale etj., duke pasqyruar ngjarje dhe episode historike, për personalitetin e lartë fetar, Abatin e fundit të Mirditës prelatin imzot Frano Gjinit dhe sekretarin e fundit të tij dhe Abacisë së Mirditës mons dr. Zef Oroshin (1912-1989), themeluesi i Lidhjes Katolike Shqiptaro Amerikane (15 Qershor 1962). Në këtë mënyrë mons. dr.

Oroshi si një mirditor i vendosur çoi në vend amanetin apo testamentin e eprorit të tij, prelatit dhe Abatit të Mirditës imzot Frano Gjini, i cili, ia kishte lënë porosi apo në besë këtij burri sypatrembur me tradita e zakone tipike shqiptare, kur e porositi që të hap kisha të reja për popullin apo emigrantët shqiptarë kudo që të jenë, duke dëshmuar se shqiptarët e kanë dashur dhe e duan shumë shembylltyrën e Krishtit të përvuajtur dhe të kryqzuar për ne...

Libri është i ndarë në pesë pjesë; pjesa e parë- Shënime dhe kujtime historike mbi abat Gjinit dhe Abacinë, pjesa e dytë- Letërkëmbime për çështje të ndryshme, pjesa e tretë- Komunizmi dhe arrestimi i abat Gjinit, pjesa e katërt- Vatikani shpall shenjt abat Frano Gjinit së bashku me 38 martirë të kishës katolike, Pjesa e pestë- Abat Frano Gjini dhe mons. dr. Zef Oroshi.

Vlerë e shtuar e këtij libri janë 32 dokumente arkivore (rreth 46 fletë), që përfshijnë harkun kohor të viteve 1930-1946. Nga ana e autorëve është ndjekur kronologjia në vite si dhe dokumentet faksimile janë futur në fund të librit. Letrat me shkrim dore janë bërë pjesë e librit ashtu siç janë shkruar asokohe. Letrat në fjalë, nuk janë vetëm me përmbajtje të karakterit fetarë, por mes tyre ndodhen dhe *Memorandumi* i klerit katolik në raste delikate, siç ishte tentative e Mbretërisë, për të mbyllur shkollat e huaja e ndër ta dhe ato fetare në vitin



1933. Po ashtu këtu përfshihet edhe relacioni i klerit katolik, që i dërgohet Kryeministrit në vitin 1946, ku merret vendimi për të mbyllur seminarin, në të dy këto raste në fund është dhe firma e Abat Gjinit. Kjo pjesë e librit me letra, relacione, memorandume etj., ku, abati mons. Frano Gjini është drejtpërdrejt ose tërthorazi i përfshirë në këto dokumente historike, janë lënë qëllimisht tekstualisht pa bërë komente, pasi letrat flasin vetë dhe interpretimet janë të tepërta.

Një hapësirë të konsiderueshme zë dhe dosja e gjyqit ku trajtohet gjerësisht, për herë të parë bëhen publike letrat që ai i dërgon Gjyqit të Lartë Ushtarak në Shkodër në vitin 1948, apo letra që familjarët e tij i dërgojnë po kësaj Gjykate për faljen e tij.

Pastaj bëhet lidhja mes Abat Gjini dhe mons. dr. Zef Oroshi, këto të dy janë figura të mëdha të Mirditës, të cilët këto vitet e fundit falë studiuesve po ndriçohen mbi bazën e dokumenteve historike. Këto prelatë të kishës katolike shqiptare në vendlindje dhe diasporë për fat të mirë po zbardhen shumë mirë në librin në fjalë, që tashmë kemi në dorë, të shkruar me gjuhën e fakteve dhe dokumenteve të reja nga bashkautorët Mrijaj – Laçi.

Në ditët kur regjimi komunist po konsolidonte diktaturën e vet ushtarake, në abacinë e Mirditës, sikurse shkruan studiuesi Tomë Mrijaj, një ndër miqët më të ngushtë të mons. Oroshit, zhvillohet një takim shumë i rëndësishëm në Abaci, në mes abatit të Mirditës mons. Frano Gjinit, mons. dr. Zef Oroshit dhe Kapidanit të Mirditës Llesh Gjonmarku që kishte ardhur nga forcat e rezistencës kundërkomuniste të maleve të Mirditës... Ai iu drejtua abat Gjini duke i thënë: *“Abat, unë kam ardh me ju thanë se situata këtu me këto bisha të egra komuniste, që nuk njohin as fe as atdhe, nuk asht e mirë dhe po druj se mos po ju ndodh ndonji e papritun. Na me nacionalistët anti komunist të maleve, kemi munds që t’ju largojm shendosh e mirë jasht, deri sa t’a çlirojm vendin nga komunistët, na prap ju kthejmë në Abaci. Abat Gjini nuk iu përgjigj pyetjes së Kapidanit, por vetëm si shej falenderimi i buzëqeshi lehtë... Dhe Abati, me një qetësi karakteristike mu drejtue me këto*

ffjalë: “Dom Zef, për Kapidanin edhe vdekja asht fitore. Ky ka vendos të luftoj deri në frymën e fundit. Zoti ju ndihmoftë këtyne trimave të lirisë, që po sakrifikojnë rininë e tyre. Unë prap i drejtohem Abat Gjinit, se Kapidan Llesh Gjonmarku e pat mirë që ju tha të largoheni nga Shqipnia, se komunizmi ka vendos me na vra të tanve. Por Abati i ynë, tha se nuk mendoj të largohem nga Shqipnia dhe që as më takon mue në këtë moshë si zot shtëpie të la Mirditën dhe grigjën vetëm në keto ditë të vështira për të gjithë ne... Ju duhet të largoheni dom Zef, se komunizmi e ka marrë të gjith vendin dhe po ban krime të përbindshme mbi popullin shqiptar dhe klerin katolik. Zoti i madh e din se sa ka me zgjat kjo mortaj komuniste në trojet tona. Ju duhet të largoheni për t’i dëshmue botës krimet, që janë ba në tokën tonë martire. Detyra e juaj asht që një ditë të riktheheni në trojet e Arbërit, në Mirditën legjendare, ma të përgatitun, që t’i ndërtoni nga themelet rrënojat, që po ban çdo ditë komunizmi i zi. Ju duhet me ba presion politik në vendet dhe qeveritë perendimore, ku ju do të jetoni që të rrëzohet komunizmi tek ne. Tregoni botës se shqiptarët nuk e duan këtë regjim gjakpirës bolshevikrus...”

Dhe mons. dr. Zef Oroshi e plotësoi amanetin e lënë nga Abat mons. Frano Gjini shumë dekada më parë në Mirditë, duke ndërtuar kishën e parë katolike shqiptare në SHBA, kishë e cila edhe sot mbas disa dekadave është shtëpia e ngrohtë e madhe atdhetare dhe fetare për të gjithë shqiptaro-amerikanët. Ai, me fuqinë e Zotit, arriti të bëj realitet qëllimin fisnik të misionit të tij... Mons. Oroshi, tha meshën e parë në natën e Krishtlindjes në vitin 1969, pranë Qendrës Katolike Shqiptaro Amerikane Zoja e Këshillit të Mirë, sot Zoja e Shkodrës, në Hartsdale New York, në prani të mijëra besimtarëve, pa dallim feje dhe krahine nga të gjithë trojet etnike shqiptare.

Ky libër i pasur me dokumente dhe fakte historike, do të mbetet padyshim një vepër me vlera të pa kontestueshme, për historinë e dhimbshme por edhe krenare dhe të lavdishme të martirizimit të mons. Frano Gjinit, klerit katolik dhe komunitetit të krishterë të saj.

Dr. Tonin ÇOBANI

**BUZËQESHNI NJËRI-TJETRIT! ” DHE TRE TREGIME TË VËRTETA
(OSE PJESËRISHT TË VËRTETA) NGA JETA E NËNË TEREZA**

*Në promovimin e Albumit “Nënë Tereza në pullat shqiptare” të Hysen S. Dizdarit (shqip dhe anglisht),
AGSTUDIO.al, Tiranë, 2018, 50 ff. me parathënie të Dom Lush Gjergjit.*

Duke e uruar autorin për botimin luksoz, më lejoni të ndalem shkurtimisht në atë që unë e quaj thelbin e filozofisë së Nënë Terezës “ **I buzëqeshni njëri-tjetrit! ” dhe tre tregime të vërteta (ose pjesërisht të vërteta) nga jeta e saj**, të cilat i kam pasë publikuar edhe më parë.

“ I buzëqeshni njëri-tjetrit! ”

Kudo që veptoi Nënë Tereza ka shpërfaqur me kurajë, qoftë varfërinë tradicionale, qoftë atë të zyrtarizuar. Prandaj vepra e saj “*nuk është punë sociale ose shërbim humanitar*”. Madje Nënë Tereza nuk mund të jetë as thjeshtë një bamirëse e madhe. Ajo “*kurrënmuk ka pasur fonde as për vete as për motrat e saj*”, shkrua Don Lush Gjergji në parathënien e tij. Filozofia e saj sugjeron një menaxhim ndryshe të shoqërisë njerëzore, një organizim ndryshe të institucioneve sociale, publike a jo publike, shtetërore qofshin a fetare. Asgjë më tepër se një kujdes të institucionalizuar të njeriut për njeriun, të njeriut për veten e vet.

Mund të tingëllojë si kontradiktore fjala “*kujdes*” në kontekstin moral të veprës së Nënë Terezës ku vendin më të dukshëm e ka fjala “*lutje*” dhe fjalët “*përvuajtje, bindje, sakrifica*” në ngjashmëri me vuajtjet e Krishtit. Ndoshta, në këtë dukje kontradiktore qëndron thelbi i filozofisë praktike të Nënë Terezës: ai thelb që u kërkon njerëzve asgjë më tepër se sa t’i “*buzëqeshni njëri-tjetrit!*”. Pra, me përvuajtje, me bindje, me sakrifica njerëzit t’u largohen xhelozirave, inateve, konflikteve, luftërave. Me përvuajtje, bindje dhe sakrifica t’i buzëqeshin edhe atij të vetmuarit, të pamundurit nga mplantakja, sëmundja, varfëria...

Dikush edhe mund të kundërshtojë: por kjo nuk është filozofi, është këshillë, është moral, madje moral i krishterë, pasi shenjtëresha Nënë Tereza ishte vetë një fetare praktikante e devotshme dhe rekomandonte lutjen drejtuar Zonjës së Bekuar,

Krishtit, Zoti. As teologët, përgjithësisht nuk i argumentojnë idetë dhe veprimtaritë e Nënë Terezës të cilësuar filozofikisht. Edhe Nënë Tereza asnjëherë nuk është shprehur se po filozofon, sepse ajo me shembullin e saj dhe të pasuesve të vet, pikërisht atë filozofi të derisotme që e ka katandisur botën në këtë gjendje kërkon të reformojë, atë mentalitet dhe atë moral të derisotëm kërkon të tejshkojë.

Por kush tenton të përmbysë një filozofi të tërë për jetën, propozon një filozofi të re. Filozofia e re e Nënë Terezës bazohet në vlerat e vërteta morale të vetë njerëzve që mendojnë dhe veprojnë si ajo, si motrat e saj, si vëllezërit e saj (përfshirë edhe motrat e vëllezërit laikë), si të gjithë duan të jetojnë më mirë. A nuk kemi të bëjmë me një sistem të ri idesh filozofike për jetën dhe vdekjen mbi tokë, një sistem llogaritjesh për lumturinë humane, një sistem përfundimesh për marrëdhëniet e njerëzve me njëri-tjetrin dhe me mjedisin modernist që i rrethon, gjëra këto që është rrekur t’i shterojë filozofia deri në ditët e sotme, por pa sukses? Nënë Tereza e ka vulosur suksesin e ideve të veta me veprimtarinë e saj dhe të institucioneve të ngritura prej saj. Ajo thoshte:

“Atyre që janë në prag të vdekjes mundemi që të paktën t’u japim përshtypjen e vërtetë të një gjëje shumë të rëndësishme: që ekziston dikush i gatshëm për t’i dashur me të vërtetë dhe me faktet, sepse dhe ata, si gjithë të tjerët ose, ndoshta, me të drejta më shumë se të tjerët, janë bij të Zotit dhe meritojnë të duhen.”

Tre tregime të vërteta (ose pjesërisht të vërteta) nga jeta e Nënë Terezës

Tregimi i parë:

Një vakt si zotërinjtë

Nënë Tereza që ftuar në njërin prej banketeve që shtrinin herë pas here disa ish-nxënëse të saj nga familje të kamura të Kalkutës. Ndryshe nga ç'e kishte zakon në raste të tilla, ajo qëndroi deri në fund. Kur u larguan të ftuarit dhe kamerierët filluan të mbledhin çfarë kishte mbetur ndër pjatancat, ajo iu drejtua vajzave që kishin organizuar festën:

– U thoni këtyre që ngrenë tryezat, t'i mbledhin për mua ushqimet e paprekura, ëmbëlsirat e mbetura dhe frutat. Do të dërgoj menjëherë njerëz t'i marrin për fëmijët e mi të uritur e pleqtë e sëmurë. Ah, sa do të kënaqen duke ngrënë gatime për zonja e zotërinjtë, qoftë edhe në një vakt të vetëm të jetës së tyre!

Dhe ashtu u bë. Dhe jo vetëm pas asaj gostie. Ishte ose jo e ftuar Nënë Tereza, njerëzit e saj lajmëroheshin thajse sa herë shtroheshin bankete të tilla...

Tregimi i dytë:

Dialog me President

– Do të kujdesem që të marrësh një çek me disa milion dollarë për institucione e

tua, - i tha Presidenti Regan Nënë Terezës në Washington kur po e shoqëronte me rastin e një vizite zyrtare.

– Jo, - ia priti Nënë Tereza me një vendosmëri të pafajshme, - nuk i pranoj. Nuk

marr çeqe nga qeveritë. Nuk kam marrë asnjëherë. As nga institucionet fetare.

– Si kështu?! Me se i mban shtëpitë e bamirësive në të katër anët e botës?

– Me donacione prej institucionesh jo shtetërore e jo fetare, si dhe me dhurata

individësh. Qeveria Amerikane, p.sh. (ose një institucion fetar i çfarëdo rangui), me ato dollarë, që më ofron mua, le të bëjë vetë diçka më tepër për shtëpitë e pleqve, spitalet e të varfërve dhe fëmijët e braktisur.

– Kuptova, - u tërhoq Presidenti. - Unë do të jap

disa mijëra dollarë nga të ardhurat

e mija personale. Kështu mundem?

– Po. Dhe unë me motrat e mia do t'i menaxhojmë ata dollarë, sa të jetë e

mundur më mirë, në dobi të nevojtarëve më në nevojë.

Tregimi i tretë:

Një kryq për lutje me dy shkopinj

Thjeshtësia e Nënë Terezës ka qenë proverbiale. Nënë Tereza ishte edhe racionale, tepër madje. Thjeshtësia e bënte të ishte pa kurrfarë pretendimi vetjak, ndërsa racionliteti i siguronte në çdo rast efikasitetin maksimale të bëmave të saj (dhe të motrave të saj). Kështu, Nënë Tereza nuk humbiste kohë as për të zgjedhur një altar kishe sa herë e ndiente të nevojshme të lutej. Ndodhte që ajo merrte dy shkopinj, krijonte me to një kryq, e vendoste atë kryq mbi tryezë dhe ulej në gjunjë përballë tij, duke mbështetur kokën mbi të dy duart e veta të bëra bashkë.

Motrat e saj, kur e shihnin ashtu, ose i bashkoheshin në lutje, ose shpejtonin të arrinin sa më parë aty ky e dinin se në atë çast një qenie tjetër njerëzore kishte nevojë për ta. Pas lutjes, atje do të mbërrinte menjëherë edhe Nënë Tereza.

Gazetarët, më se një herë, e kanë pyetur qortueshëm:

– Po ju, përse humbisni kohë pa fund duke ia çuar nevojtarëve peshkun në pjatë? A nuk do të ishte më mirë t'u dhuronit atyre një kallam peshkimi dhe t'u mësonit ta zinin peshkun vetë?

Edhe ajo ia kthente jo pa ironi:

– Ashtu është vërtetë, por ne, motrave, na duhet t'u ndihmojmë nevojtarëve pse janë të pamundur. Kështu që, më parë, ata duhen të bëhen të aftë ta mbajnë vetë lugën në dorë e tyre dhe, më pas, kallamin që propozoni ju për peshkim...

Duke përfunduar këtë qasje për Nënë Terezën, e falënderoj edhe një herë filatelistin Hysen S. Dizdari, i cili me punën e vet pasionante dhe sistematike na e ka afruar më afër Nënë dhe veprën e saj madhështore.

120 VITE SHOQËRIA “BASHKIMI”



Famullia e “Shën Shtjefnit” në Bashkëpunim me Bibliotekën “Marin Barleti” në Shkodër më dt.23. shkurt 2019, në sallën Kardinal Mikel Koliqi (pranë Katedrales së Shkodrës), organizuan Ekspozitën me fotografi rreth shoqërisë Bashkimi dhe promovimin e botimit fototipik “Fialuer i Rii i Sheyptes” si kryevepër të kësaj shoqërie e botuar në vitin 1908.

Fjalën përshëndetëse e mbajti famullitari i Katedrales së Shkodrës, Dom Vlash Palaj, i cili vlerësojë lartë punën e bërë të kësaj shoqërie për dhjetë vite punë intensive dhe shprehu keqardhje për gjendjen kulturore të sotme e cila ka ardhur duke u zbehur. Pastaj fjalët i rreshtuan, Gjergj Marku, Dom Nikë Ukgjini, profesorët e nderuar nga Universiteti i Shkodrës, kryetarja e bashkisë së Shkodër, Voltana Ademi, ambasadori i Kosovës, Syle Ukshini, e të tjerë. Botuesi Frano Kulli, foli për punën e bërë rreth ribotimit të fjalorit dhe rolin që e ka si relikto kulturore. Miqtë të shumtë e të ftuar e shijuan ekspozitën e formatuar dhe kuruar me kujdes dhe profesionalizëm të lartë nga prof. Shpend Bengu.





DOM ANTON KÇIRA
AMBASADOR I
SHQIPTARËVE NË SHBA
 Botime LUMBARDHI,
 Prizren - Gjakovë 2018



ALESSANDRO SERRA

Shqipëria dhe Selia e
Shenjtë në kohën e Gjergj
Kastriotit

Drita - Prishtinë, 2018



Tomë Mrijaj & Leonora Laçi

ABATI I MIRDITËS
IMZOT FRANO GJINI

Volaj, Shkodër 2012

KUMBONA E SË DIELLËS
 revistë fetaro-kulturore dymujore
 e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult
 Tirazhi: 1000 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë
 (Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeshkoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
 Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë